



FLETORJA ZYRTARE

E

REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare

Nr. 24

2002

Gusht

P Ë R M B A J T J A

Faqe

Ligj nr. 8892
datë 14.5.2002

Marrëveshja e tregtisë së lirë ndërmjet Qeverisë Shqiptare
dhe Qeverisë
Maqedonase.....

3

L I G J
Nr.8892, datë 14.5.2002

PËR RATIFIKIMIN E “MARRËVESHJES SË TREGTISË SË LIRË NDËRMJET QEVERISË SHQIPTARE DHE QEVERISË MAQEDONASE”

Në mbështetje të neneve 78, 81 pika 1, 83 pika 1 dhe 121 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

K U V E N D I

I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË
V E N D O S I:

Neni 1

Ratifikohet “Marrëveshja e tregtisë së lirë ndërmjet Qeverisë Shqiptare dhe Qeverisë Maqedonase”

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Shpallur me dekretin nr. 3353, datë 30.5.2002 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Rexhep Meidani

MARRËVESHJE

PËR TREGTINË E LIRË MIDIS QEVERISË SHQIPTARE DHE QEVERISË MAQEDONE

Preambula

Të dëshiruar për të zhvilluar dhe fuqizuar marrëdhënie miqësore, veçanërisht në fushën e bashkëpunimit ekonomik dhe tregtar, me qëllim që të kontribuojnë në zhvillimin e bashkëpunimit ekonomik mes dy vendeve dhe të rrisin vëllimin e shkëmbimit reciprok tregtar,

Qeveria shqiptare dhe Qeveria Maqedone

(këtu e më tutje të quajtura "Palë Kontraktuese")

Duke riafirmuar angazhimin e tyre në parimet e ekonomisë së tregut, të cilat përbëjnë bazën e marrëdhënieve të tyre,

Duke patur parasysh dëshirën e tyre të përbashkët për të marrë pjesë në mënyrë efektive në procesin e integrimit ekonomik ndërkombëtar,

Duke shprehur gatishmërinë e tyre për të bashkëpunuar në gjetjen e mënyrave dhe mjeteve për të fuqizuar këtë proces,

Të vendosur në këtë dhe që të eliminojnë në mënyrë progresive pengesave në praktikisht të gjithë tregtinë e tyre reciproke, në përputhje me dispozitat e Marrëveshjes së Përgjithshme mbi tarifatat dhe Tregtinë (GATT, 1994) dhe me Marrëveshjen e Marrakeshit, e cila themeloi Organizatën Botërore të Tregtisë (OBT)

Deklarojnë gatishmërinë e tyre për të ndërmarrë aktivitetet me qëllim të nxitjes së zhvillimit të harmonishëm të tregtisë së tyre, po ashtu si dhe të zgjerimit dhe ndryshimit të bashkëpunimit të tyre reciprok në fusha me interes të përbashkët, duke përfshirë edhe fusha të pambuluara nga kjo Marrëveshje, duke krijuar në këtë mënyrë një kuadër dhe ambient mbështetës, i bazuar në cilësinë, jodiskriminimin dhe barazpeshën e të drejtave dhe detyrimeve,

Fuqimisht të bindur se kjo Marrëveshje do të nxisë intensifikimin e tregtisë përfituese mes tyre dhe do të sjellë në procesin e integrimit në Evropë,

Duke pasur parasysh se asnjë dispozitë e kësaj Marrëveshjeje mund të interpretohet si e tillë që t'i përjashtojë Palët nga detyrimet e tyre nën marrëveshje të tjera ndërkombëtare, veçanërisht

Marrëveshjen e Përgjithshme mbi Tarifat dhe Tregtinë të vitit 1994 dhe Marrëveshjen e Marrakesh-it, e cila themeloi Organizatën Botërore të Tregtisë,

Kanë vendosur, në ndjekje të këtyre objektivave, të lidhin Marrëveshjen e mëposhtme (këtu e më tutje të quajtur si "kjo Marrëveshje"):

Neni 1 **Objektivat**

Palët Kontraktuese do të krijojnë gradualisht një zonë të tregtisë së lirë gjatë një periudhe tranzitore që zgjatet në një maksimum prej gjashtë vjetësh, duke filluar nga hyrja në fuqi e kësaj Marrëveshjeje, në përputhje me dispozitat e kësaj Marrëveshjeje dhe në përputhje me përcaktimin, të shprehur në nenin XXIV të Marrëveshjes GATT të vitit 1994 dhe Marrëveshjes së Marrakeshit, e cila themeloi OBT-në.

2. Objektivat e kësaj Marrëveshjeje janë:

- a) të zgjerojë bashkëpunimin ekonomik të të dyja vendeve dhe të rrisë standartin e jetesës së popujve të tyre;
- b) të eliminojë gradualisht kufizimet në tregtinë e mallrave;
- c) të vendosë kushte të barabarta konkurrence për tregti në mes të Palëve Kontraktuese;
- d) të kontribuojë në këtë mënyrë në heqjen e barrierave ndaj tregtisë, në zhvillimin e harmonishëm dhe në zgjerimin e tregtisë botërore;
- e) të rrisë bashkëpunimin mes Palëve Kontraktuese;
- f) të krijojë kushte për nxitje të mëtejshme të investimeve, veçanërisht për zhvillimin e investimeve të përbashkëta në të dyja vendet;
- g) të nxisë tregtinë dhe bashkëpunimin e Palëve Kontraktuese në tregjet e vendeve të treta.

KREU I **PRODUKTET INDUSTRIALE**

Neni 2 **Qëllimi**

Dispozita e këtij Kreu do të aplikohen mbi produktet industriale, me origjinë në njërën nga Palët Kontraktuese. Për qëllimin e kësaj Marrëveshjeje, termi "produkte industriale" do të thotë produkte, të cilat klasifikohen në kapitujt 25 dhe 97 sipas përshkrimit të mallrave në Sistemin e Harmonizuar të mallrave dhe Kodit Doganor, me përjashtim të produkteve, të listuara në aneksin I.

Neni 3 **Tarifa doganore bazë**

1. Për shkëmbimet tregtare të mbuluara nga kjo Marrëveshje, Tarifat Doganore të Republikës së Maqedonisë duhet të aplikohen në klasifikimin e mallrave të importuara në Republikën e Maqedonisë. Tarifat doganore të Republikës së Shqipërisë duhet të aplikohen në klasifikimin e mallrave të importuara në Republikën e Shqipërisë.

2. Për secilin produkt, tarifa doganore bazë që do të aplikohet, dhe që do t'i nënshtrohet reduktimeve të mëvonshme, të përcaktuara në këtë Marrëveshje, duhet të jetë tarifa e parimit të kombit më të favorizuar, e aplikueshme nga Palët Kontraktuese më 1 janar 2002.

3. Në rast se pas kësaj date bëhen reduktime tarifore të aplikuara sipas parimit erga omnes, sidomos reduktimet e rezultuara nga marrëveshjet tarifore në Raundin e Uruguajt GATT 1994 dhe të Marrëveshjes së Marrakeshit që themeloi OBT-në, tarifat e rezultuara nga këto reduktime duhet të zëvendësojnë tarifat doganore bazë sipas paragrafit 2, nga data e zbatimit të reduktimit.

4. Tarifat doganore të reduktuara, të llogaritura në përputhje me paragrafin 2, duhet të rumbullakosen, në përputhje me rregullat aritmetike, me dy shifra dhjetore për mallrat e importuar në Maqedoni dhe pa shifra dhjetore për mallrat e importuar në Shqipëri.

5. Palët Kontraktuese duhet të këmbëjnë reciprokisht informacionin mbi tarifat e tyre doganore bazë.

Neni 4

Tarifat doganore mbi importet

1. Që nga data e hyrjes në fuqi të kësaj Marrëveshjeje, as nuk do të vihen në zbatim tarifa doganore të reja mbi importet, as edhe nuk do të rritet niveli i atyre që tashmë zbatohen në tregtinë mes Palëve Kontraktuese.

2. Tarifat doganore mbi importet, të aplikueshme në Republikën e Shqipërisë mbi produktet me origjinë në Republikën e Maqedonisë, të specifikuara në aneksin II, do të ulen progresivisht dhe do të eliminohen në përputhje me një program kohor të paraqitur në këtë Aneks.

3. Tarifat doganore mbi importet, të aplikueshme në Republikën e Maqedonisë mbi produktet me origjinë në Republikën e Shqipërisë, të specifikuara në aneksin III, do të ulen progresivisht dhe do të eliminohen në përputhje me një program kohor të paraqitur në këtë aneks.

4. Çdo ndryshim në angazhimet e marra nga Pala Maqedonase dhe Shqiptare në Komunitetin Europian, në lidhje me sa sipër, duhet t'i raportohet Komitetit të Përbashkët.

Neni 5

Detyrime të tjera ekuivalente me tarifat doganore

1. Asnjë detyrim i ri, i cili ka efekt të barabartë me tarifat doganore mbi importet, nuk do të hyjë në fuqi në tregtinë ndërmjet Palëve Kontraktuese.

2. Të gjitha detyrimet, të cilat kanë efekt të barabartë me tarifat doganore mbi importet, do të eliminohen në datën e hyrjes në fuqi të kësaj Marrëveshjeje.

Neni 6

Detyrimet fiskale

Dispozitat e nenit 4 do të zbatohen gjithashtu dhe për detyrimet doganore me natyrë fiskale.

Neni 7

Tarifat doganore mbi eksportet dhe detyrime të tjera, të cilat kanë efekt ekuivalent me tarifat doganore

1. Asnjë tarifë e re doganore mbi eksportet ose detyrim që ka efekt të barabartë nuk do të hyjë në fuqi dhe zbatohet në tregtinë mes Palëve Kontraktuese.

2. Në datën e hyrjes në fuqi të kësaj Marrëveshjeje, Palët Kontraktuese do të heqin mes tyre të gjitha tarifat doganore mbi eksportet, si dhe detyrimet mbi eksportet që kanë efekt të barabartë me tarifat.

Neni 8

Kufizimet Sasiore mbi eksportet dhe importet si dhe masat që kanë efekt ekuivalent

1. Asnjë kufizim i ri sasior mbi eksportet dhe importet ose masa që kanë efekt të barabartë nuk do të hyjë në fuqi dhe zbatohet, as edhe kufizimet sasiore ekzistuese nuk do të bëhen më kufizuese në tregtinë mes Palëve Kontraktuese që nga data e hyrjes në fuqi të kësaj Marrëveshjeje.

2. Të gjitha kufizimet sasiore mbi eksportet nga Palët Kontraktuese dhe masat që kanë efekt të barabartë do të hiqen që nga data e hyrjes në fuqi të kësaj Marrëveshjeje.

Neni 9

Pengesat teknike në tregti

1. Të drejtat dhe detyrimet e Palëve Kontraktuese në lidhje me standartet dhe rregullat teknike, si dhe masat respektive, do të zbatohen në përputhje me Marrëveshjen e OBT-së mbi barrierat teknike në tregti.

2. Palët Kontraktuese duhet të bashkëpunojnë dhe të shkëmbejnë informacion në fushën e standartizimit, metrologjisë, vlerësimit të konformitetit dhe akreditimit, me qëllim të eliminimit të barrierave teknike në tregti.

3. Çdo Palë Kontraktuese, me kërkesë të Palës tjetër, duhet të japë informacion mbi rastet individuale të veçanta të standarteve, rregullave teknike ose masave të ngjashme me to.

4. Palët Kontraktuese do të hyjnë në negociata, aty ku është e përshtatshme, me qëllim konkludimin e marrëveshjeve mbi njohjen reciproke në fushën e vlerësimit të konformitetit, bazuar në rekomandimet e Marrëveshjes së OBT-së mbi barrierat teknike në tregti.

5. Palët Kontraktuese do të pranojnë standartet e tyre kombëtare dhe rregullat për rregullimin e standartizimit dhe metrologjisë për subjektet ligjore dhe fizike, të cilat janë rezidente në të dyja vendet, mbi baza jo diskriminuese.

KREU II PRODUKTET BUJQËSORE, PRODUKTET BUJQËSORE TË PËRPUNUARA DHE ATO TË PESHKUT

Neni 10

Qëllimi

Dispozitat e këtij Kreu duhet të aplikohen ndaj produkteve bujqësore, bujqësore të përpunuara dhe të peshkut (këtej e tutje të quajtura "produkte bujqësore"), të cilat klasifikohen në Kapitujt 1 dhe 24 të Përshkrimit të Mallit në Sistemin e Harmonizuar të Mallrave dhe Kodit Doganor, si dhe ndaj produkteve të listuara në aneksin I të kësaj Marrëveshje, me origjinë nga një prej Palëve Kontraktuese.

Neni 11

Kufizimet sasiore në eksporte dhe masat me efekt ekuivalent

1. Asnjë kufizim i ri sasior në eksporte ose masa, që kanë efekt ekuivalent nuk do të zbatohen dhe as ato ekzistueset nuk do të bëhen më kufizuese në tregtinë midis Palëve Kontraktuese nga data e hyrjes në fuqi të kësaj Marrëveshjeje.

2. Të gjitha kufizimet sasiore në eksporte nga Palët Kontraktuese dhe masat që kanë efekt ekuivalent do të hiqen në datën e hyrjes në fuqi të kësaj Marrëveshjeje.

Neni 12

Shkëmbimi i koncesioneve

1. Palët Kontraktuese deklarojnë gatishmërinë e tyre për të fuqizuar, për aq sa politikat e tyre bujqësore e lejojnë, zhvillimin e harmonishëm të tregtisë në produktet bujqësore dhe për ta diskutuar këtë çështje në mënyrë periodike brenda Komitetit të Përbashkët.

2. Në ndjekje të këtij objekti, Palët Kontraktuese i japin njëri-tjetrit koncesionet e specifikuar në Protokollin A, duke siguruar për nxjerrjen e masave për lehtësimin e tregtisë në produktet bujqësore, në përputhje me dispozitat e këtij Kreu dhe ato të përcaktuara në këtë Protokoll.

3. Duke pasur parasysh:

- rolin e bujqësisë në ekonominë e tyre;
- zhvillimin e tregtisë së produkteve bujqësore mes Palëve Kontraktuese;
- sensitivitetin e veçantë të produkteve bujqësore;
- rregullat sipas politikave të tyre bujqësore;
- pasojat e negociatave shumëpalëshe tregtare sipas GATT-it dhe OBT-së Palët. Palët Kontraktuese duhet të shqyrtojnë mundësitë e dhënies për njëri-tjetrit të koncesioneve të mëtejshme.

Neni 13

Koncesionet dhe politikat bujqësore

1. Pa paragjykuar koncesionet, të dhënat në Nenin 12, dispozitat e këtij Kreu nuk do të kufizojnë në ndonjë mënyrë ndjekjen e politikave përkatëse bujqësore të Palëve Kontraktuese ose

aplikimin e ndonjë mase mbështetur në këto politika, duke përfshirë zbatimin e dispozitës së Marrëveshjes së OBT-së për Bujqësinë.

2. Palët kontraktuese duhet të njoftojnë Komitetin e Përbashkët në lidhje me ndryshimet në politikat e tyre përkatëse bujqësore të ndjekura ose masat e aplikuara, të cilat mund të ndikojnë në kushtet e tregtisë së mallrave bujqësore mes tyre, sikurse përcaktohet në këtë Marrëveshje. Në bazë të kërkesës së një nga Palët Kontraktuese duhet të mbahen konsultime të menjëhershme brenda Komitetit të Përbashkët për të ekzaminuar situatën.

Neni 14

Masa mbrojtëse specifike

Pavarësisht nga dispozita e tjera të kësaj Marrëveshjeje dhe, në veçanti, nenit 20, si dhe në bazë të sensitivitetit të veçantë të produkteve bujqësore, në rast se importet e produkteve me origjinë nga një Palë Kontraktuese, të cilat janë subjekt koncesionesh të dhëna në këtë Marrëveshje, sjellin probleme serioze në tregjet e Palës tjetër Kontraktuese Palët duhet menjëherë të hyjnë në konsultime për të gjetur një zgjidhje të përshtatshme. Deri në këtë zgjidhje, Pala Kontraktuese e prekur mund të marrë masat që ajo i konsideron të nevojshme.

Neni 15

Masat sanitare dhe fitosanitare

1. Palët Kontraktuese duhet të aplikojnë rregullat e tyre kombëtare në fushat e kontrollit veterinar, sanitar dhe fitosanitar në përputhje me Marrëveshjen e OBT-së mbi masat sanitare dhe fitosanitare.

2. Masat që kanë të bëjnë me kontrollin veterinar dhe fitosanitar mes Palëve Kontraktuese duhet të harmonizohen mbi bazën e legjislacionit të Bashkimit Europian.

3. Palët Kontraktuese zotohen të mos aplikojnë masa diskriminuese ose masa të tjera të cilat çojnë në kufizimin e papërshtatshëm të fluksit të informacionit lidhur me nivelin e mbrojtjes sanitare dhe fitosanitare, të kafshëve, bimëve dhe produkteve.

KREU III

DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 16

Taksimi i brendshëm

1. Palët Kontraktuese duhet të evitojnë marrjen e ndonjë mase ose praktike me natyrë fiskale të brendshme, e cila krijon direkt ose indirekt diskriminim ndaj produkteve me origjinë nga Palët Kontraktuese.

2. Produktet e eksportuara në një nga Palët Kontraktuese nuk duhet të përfitojnë nga rimbursime të taksave të brendshme përtej sasisë së taksës indirekt të aplikuar mbi to.

Neni 17

Bashkimet doganore, zonat e tregtisë së lirë dhe tregtia kufitare

1. Kjo Marrëveshje nuk do të ndalojë mbajtjen ose krijimin e bashkimeve doganore e zonave të tregtisë së lirë ose të rregullimeve në tregtinë kufitare, në masën që këto nuk ndikojnë negativisht në regjimin tregtar të Palëve Kontraktuese dhe, në veçanti, në dispozitat që kanë të bëjnë me rregullat e origjinës, të përcaktuara në këtë Marrëveshje.

2. Sipas kërkesës, Palët Kontraktuese duhet të informojnë njera-tjetrën për çdo lloj marrëveshjeje që vendos bashkime doganore ose zona të tregtisë së lirë.

Neni 18

Axhustime strukturore

1. Masa të jashtëzakonshme me kohëzgjatje të kufizuar, të dala nga dispozitat e nenit 4, mund të merren nga secili nga Palët Kontraktuese në formën e tarifave të rritura doganore.

2. Këto masa mund të kenë të bëjnë vetëm me industrinë në lindje e sipër, ose disa sektorë që po kryejnë ristrukturim ose po përballojnë vështirësi serioze, veçanërisht aty ku këto vështirësi gjenerojnë probleme shoqërore të konsiderueshme.

3. Tarifat doganore mbi importet, të aplikueshme nga Pala Kontraktuese në lidhje me produktet me origjinë nga Pala tjetër, të hyra në fuqi me anë të masave të mësipërme, nuk mund të tejkalojnë 25% ad valorem dhe duhet të mbeten një element preference për produktet, me origjinë në Palën tjetër. Vlera totale e importeve të produktit, subjekt i këtyre masave, nuk mund të tejkalojë 15% të importeve totale të produkteve industriale nga Pala tjetër Kontraktuese, sikurse përcaktohet në nenin 4, gjatë vitit të fundit për të cilin ka të dhëna statistikore.

4. Pala Kontraktuese e interesuar duhet të informojë Komitetin e Përbashkët për çdo lloj mase të jashtëzakonshme që synon të marrë dhe, me kërkesë të Palës tjetër, duhet të bëhen konsultime në Komitetin e Përbashkët mbi të tilla masa dhe në sektorët për të cilët do të aplikohen para se të aplikohen. Kur të jetë duke marrë të tilla masa, Pala e interesuar duhet t'i japë Komitetit të Përbashkët një program në nivele dhe kohë për eliminimin e tarifave doganore, të hyra në fuqi sipas këtij neni. Ky program do të sigurojë mënyrën se si do të reduktohen deri në eliminim të këtyre tarifave, duke filluar nga të paktën dy vitet e fundit pas hyrjes në fuqi dhe zbatimit të tyre, me nivele vjetore të barbart. Komiteti i Përbashkët mund të vendosë për një program të ndryshëm nga ai i paraqitur.

Neni 19

Masat anti-dumping dhe kompensuese

Asgjë në këtë Marrëveshje nuk duhet të paragjykojë ose të ndikojë në ndonjë mënyrë në marrjen e masave anti-dumping apo kompensuese nga secila prej Palëve në përputhje me nenin VI të GATT 1994, me Marrëveshjen mbi implementimin e nenit VI të GATT 1994 dhe me Marrëveshjen mbi subvencionet dhe masat Kompensuese.

Neni 20

Masat mbrojtëse të përgjithshme

Kur një produkt importohet në një nga Palët Kontraktuese në sasi të tilla të rritura dhe në kushte të tilla që shkaktojnë ose rrezikojnë të shkaktojnë:

a) dëme serioze tek prodhuesi vendas të produkteve të ngjashme ose drejtpërsëdrejti konkurruese në territorin e Palës importuese; ose

b) vështirësi serioze ndaj çdo sektori të lidhur me të në ekonomi ose vështirësi që mund të sjellin përkeqësim serioz të situatës ekonomike të një rajoni,

Pala Kontraktuese e interesuar mund të marrë masat e duhura nën kushtet dhe në përputhje me procedurën, të vendosur në nenin 23.

Neni 21

Rieksporti dhe mungesat serioze

1. Aty ku përshtatja me dispozitat e neneve 7 dhe 8 të çon tek:

(a) ri-eksporti ndaj një vendi të tretë, përkundrejt të cilit Pala Kontraktuese e interesuar mban për produktet në fjalë kufizime sasiore eksporti, tarifa eksporti ose masa dhe detyrime që kanë efekt të barabartë; ose

(b) një mungesë serioze ose një rrezik për një mungesë të tillë të një produkti thelbësor për Palën Kontraktuese eksportuese;

dhe ku situatat që i referohen rasteve të mësipërme sjellin ose janë në gjendje të sjellin vështirësi për Palën eksportuese, atëherë kjo Palë Kontraktuese mund të marrë masat e duhura sipas kushteve dhe në përputhje me procedurat e përcaktuara në Nenin 23.

2. Masat e marra si rezultat i një situate të referuar në paragrafin 1, duhet të aplikohen në një mënyrë jo diskriminuese dhe të eliminohen atëherë kur kushtet nuk e justifikojnë më mbajtjen e tyre.

Neni 22
Monopolet shtetërore

1. Palët Kontraktuese duhet të përshtasin në mënyrë progresive çdo monopol shteti të një karakteri tregtar, në mënyrë që të sigurojnë që nuk do të ketë diskriminim lidhur me kushtet në të cilat mallrat janë siguruar dhe rregulluar nëpërmjet kombasve (shtetasve) të Palëve Kontraktuese.

2. Komiteti i Përbashkët duhet të informohet lidhur me masat e adaptuara për të zbatuar këtë objektiv.

Neni 23
Procedura për aplikimin e masave të ruajtjes

1. Përpara fillimit të procedurës për aplikimin e masave të ruajtjes, të përcaktuara në paragrafët e Nenit të tanishëm, Palët Kontraktuese duhet të përpiqen të zgjidhin çdo lloj ndryshimi mes tyre me anë të konsultimeve të drejtpërdrejta.

2. Në rast se një Palë Kontraktuese e kanalizon importin e produkteve, të cilat sjellin situatën e referuar në nenin 20, drejt një procedure administrative, qëllimi i së cilës është dhënia e shpejtë e informacionit mbi tendencën e flukseve tregtare, ajo duhet të informojë Palën tjetër.

3. Pa paragjykim ndaj paragrafit 7 të nenit të tanishëm, një Palë Kontraktuese që mendon të kalojë në masa ruajtëse duhet të njoftojë zyrtarisht (notifikojë) menjëherë Palën tjetër për këtë gjë dhe të japë të gjithë informacionin e duhur. Konsultimet mes Palëve Kontraktuese duhet të kryhen pa vonesë në Komitetin e Përbashkët me synim që të gjendet një zgjidhje e pranueshme reciprokisht.

4. (a) Përsa i përket neneve 19, 20 dhe 21, Komiteti i Përbashkët duhet të ekzaminojë rastin e situatës dhe mund të marrë çdo lloj vendimi që nevojitet për t'i dhënë fund vështirësive të notifikuara nga Pala e interesuar. Në rastin e mungesës së një vendimit të tillë, brenda tridhjetë ditëve nga referimi i çështjes në Komitetin e Përbashkët, Pala Kontraktuese e interesuar mund të marrë masat e nevojshme për të rregulluar situatën.

(b) Përsa i përket nenit 34, Pala Kontraktuese e interesuar mund të marrë masat e duhura pasi konsultimet janë përfunduar ose pasi ka kaluar një periudhë prej tre muajsh që nga data e notifikimit të parë ndaj Palës tjetër,

(c) Përsa i përket nenit 27, Pala Kontraktuese e interesuar duhet t'i japë Komitetit të Përbashkët të gjithë asistencën e kërkuar me qëllim që të ekzaminojë rastin dhe, ku duhet, të eliminojë praktikën për të cilat ka kundërshtim. Në rast se Pala tjetër Kontraktuese dështon për t'i dhënë fund praktikës që kundërshtohet brenda një periudhe të fiksuar nga Komiteti i Përbashkët, ose në rast se Komiteti i Përbashkët dështon në arritjen e një marrëveshjeje lidhur me këtë çështje brenda 30 ditëve pune, atëherë Pala e interesuar mund të adaptojë masat e duhura për të përballuar vështirësitë që rezultojnë nga praktika në fjalë.

5. Masat ruajtëse të marra duhet të notifikohen menjëherë në Komitetin e Përbashkët. Ato duhet të kufizohen, përsa i përket shtrirjes së tyre në mallra dhe zgjatjes në kohë, me aq sa është e domosdoshme për të rregulluar situatën dhe nuk duhet të tejkalojnë dëmin shkaktuar nga praktika ose vështirësia në fjalë. Prioritet i duhet dhënë masave që do të vështirësojnë sa më pak funksionimin e kësaj Marrëveshjeje.

6. Masat e ruajtjes të marra duhet të jenë objekt i konsultimeve periodike brenda Komitetit të Përbashkët, me synim lehtësimin ose heqjen e tyre atëherë kur kushtet nuk do ta justifikojnë më mbajtjen e tyre.

7. Atëherë kur rrethanat e jashtëzakonshme, të cilat kërkojnë veprim të menjëhershëm, e bëjnë ekzaminimin paraprak të pamundur, Pala Kontraktuese e interesuar, në ratet e neneve 19, 20 dhe 21 mund të aplikojë masa sigurorese, të cilat janë medoemos të domosdoshme për të rregulluar situatën. Masat duhet të notifikohen pa vonesë dhe konsultimet mes Palëve Kontraktuese duhet të zhvillohen sa më shpejt që të jetë e mundur në Komitetin e Përbashkët.

Neni 24
Përfshirja e përgjithshme

Kjo Marrëveshje nuk do të përfshijë ndalime ose kufizime mbi importet, eksportet ose mallrat

në transit që kryhen mbi bazën e moralit publik, e politikës publike ose e sigurisë së rendit publik, e mbrojtjes së shëndetit dhe të jetës së njerëzve, të kafshëve, bimëve e ambientit; mbrojtja e pasurive kombëtare që përmbajnë vlera artistike, historike dhe arkeologjike; mbrojtja e rregullave të pronësisë intelektuale ose rregullat që lidhen me arin apo argjendin, ose me ruajtjen e rezervave natyrore të fundme, në rast se këto masa bëhen efektive në lidhje me kufizime në prodhimin ose konsumin e brendshëm. Të tilla ndalime ose kufizime nuk duhet, sidoqoftë, të përbëjnë një mjet diskriminimi arbitrar apo një kufizim i fshehur mbi tregtinë mes Palëve Kontraktuese.

Neni 25

Rregulla të origjinës dhe bashkëpunimi në administratën e doganave

1. Protokolli B i kësaj Marrëveshje përcakton rregullat e origjinës dhe metodat që lidhen me bashkëpunimin administrativ.

2. Palët Kontraktuese duhet të marrin masat e duhura, duke përfshirë rishikime të rregullta në Komitetin e Përbashkët dhe rregullime për bashkëpunimin administrativ, për të siguruar që dispozitat e Protokollit B dhe nenet 3 e 9, 13, 16 dhe 18 të kësaj Marrëveshjeje janë aplikuar në mënyrë efektive dhe të harmonishme, si dhe për të reduktuar sa të jetë e mundur më shumë, formalitetet e imponuara mbi tregtinë dhe për të arritur zgjidhje të kënaqshme reciproke me futjen në veprim të këtyre dispozitave.

Neni 26

Pagesat

Palët Kontraktuese, në përputhje me legjislacionin e tyre respektiv, do të lejojnë në valuta të konvertueshme lirisht të gjitha pagesat në llogaritë korente të bilancit të pagesave, për aq sa transaksionet e lidhura me pagesat do të ndikojnë mbi tregtinë, për aq kohë sa Palët Kontraktuese nuk kanë rënë dakort për të vepruar ndryshe.

Neni 27

Rregullat e konkurrencës mes sipërmarrjeve. Ndihma shtetërore

1. Çfarë vijon është e papajtueshme me funksionimin e duhur të kësaj Marrëveshjeje, në rast se këto veprime prekin tregtinë mes Palëve:

a) të gjitha marrëveshjet ndërmjet sipërmarrjeve (biznesit), vendimet me përfshirjen e sipërmarrjeve dhe praktikave të përbashkëta ndërmjet sipërmarrjeve të cilat kanë si objekt të tyre ose pasojë parandalimin, kufizimin ose devijimin e konkurrencës;

b) abuzimi nga një ose më shumë sipërmarrje i pozicionit dominues në territoret e Palëve si një e tërë ose në pjesë thelbësore;

c) çdo lloj ndihme shtetërore, e cila devijon ose rrezikon të devijojë konkurrencën duke favorizuar sipërmarrje të caktuara ose prodhimin e produkteve të caktuara.

2. Secila Palë duhet të sigurojë transparencën në fushën e ndihmës shtetërore. Me kërkesë të një Pale, Pala tjetër duhet të japë informacion mbi rastet individuale të veçanta të ndihmës shtetërore.

3. Me qëllimin e aplikimit të dispozitave të paragrafit 1 të këtij neni, Palët do të marrin masa në përputhje me procedurat dhe nën kushtet e përcaktuara me marrëveshjet e tyre përkatëse me Bashkimin Evropian. Në rast të ndonjë ndryshimi me këto procedura dhe/ose kushte, këto ndryshime do të bëhen të aplikueshme mes Palëve.

4. Në rast se Palët konsiderojnë që një rast i veçantë është i papajtueshëm me kushtet e paragrafit të parë të këtij neni, dhe:

a) nuk është trajtuar si duhet sipas rregullave zbatues të referuara në paragrafin 3 të këtij neni; ose

b) në mungesë të rregullave të tilla dhe në rast se një praktikë e tillë shkakton ose rrezikon të shkaktojë dëm serioz në interesin e Palës tjetër ose dëmtim material ndaj industrisë vendase të saj, duke përfshirë industrinë e saj të shërbimeve,

atëherë Pala e interesuar mund të marrë masat e duhura pas konsultimeve brenda në Komitetin

e Përbashkët ose pas tridhjetë ditëve pune që vijnë pas referimit të këtyre konsultimeve.

1. Dispozitat e paragrafit 1(c) nuk do të aplikohen për produktet e referuara në kreun II.

2. Në rastin e praktikave të papajtueshme me paragrafin 1 c) të këtij neni, këto masa të duhura mund, aty ku Marrëveshja OBT/GATT 1994 aplikohet, vetëm të adaptohen në përputhje me procedurat dhe nën kushtet e përcaktuara nga Marrëveshja OBT/GATT 1994 dhe nga çdo tjetër instrument i rëndësishëm i negociuar nën rregullat e kësaj Marrëveshjeje, të cilat janë të aplikueshme mes Palëve.

3. Megjithë, ndonjë dispozitë të adaptuar në të kundërt me paragrafin 3 të këtij neni, Palët duhet të shkëmbejnë informacionin duke marrë parasysh kufizimet e imponuara nga kërkesat e sekretit profesional dhe të biznesit.

Neni 28

Vështirësitë e bilancit të pagesave

Aty ku njëra nga Palët Kontraktuese është në vështirësi serioze të bilancit të pagesave ose rrezikohet drejtpërsëdrejti, Pala e interesuar mundet që të adaptojë, në përputhje me kushtet e përcaktuara nga GATT 1994 dhe me nenin VIII të neneve të Marrëveshjes me Fondin Monetar Ndërkombëtar, masa kufizuese, duke përfshirë masa që lidhen me importet; masa që do të jenë me kohëzgjatje të kufizuar dhe që nuk duhet të shkojnë më tutje se çfarë është e domosdoshme për të rregulluar situatën e bilancit të pagesave. Masat do të lehtësohen në mënyrë progresive dhe ato do të eliminohen atëherë kur kushtet nuk do ta justifikojnë më tej mbajtjen e tyre. Pala Kontraktuese e interesuar do të informojë Palën tjetër për futjen e këtyre masave dhe, aty ku është e praktikueshme, do të japë një program kohor për heqjen e tyre.

Neni 29

Të drejtat e pronësisë intelektuale

Aty ku njëra nga Palët Kontraktuese është në vështirësi serioze të bilancit të pagesave, dhe rrezikohet drejtpërsëdrejti, Pala e interesuar mundet që të adaptojë, në përputhje me kushtet e përcaktuar nga GATT 1994 dhe me nenin VIII të neneve të Marrëveshjes me Fondin Monetar Ndërkombëtar, masa kufizuese, duke përfshirë masa që lidhen me importe; masa që do të jenë me kohëzgjatje të kufizuar dhe që nuk duhet të shkojnë më tutje se çfarë është e domosdoshme për të rregulluar situatën e bilancit të pagesave. Masat do të lehtësohen në mënyrë progresive dhe ato do të eliminohen atëherë kur kushtet nuk do ta justifikojnë më tej mbajtjen e tyre. Pala Kontraktuese e interesuar do të informojë Palën tjetër për futjen e këtyre masave dhe, aty ku është e praktikueshme, do të japë një program kohor për heqjen e tyre.

Neni 29

Të drejtat e pronësisë intelektuale

1. Palët Kontraktuese do të akordojnë dhe sigurojnë një mbrojtje të efektshme dhe të përshtatshme të të drejtave të pronësisë intelektuale mbi një bazë jodiskriminuese, duke parashikuar masa efektive për të imponuar respektimin e këtyre të drejtave kundër shkeljeve dhe, në veçanti, kundër falsifikimit dhe piraterisë. Palët Kontraktuese bien dakord të veprojnë në përputhje me standartet thelbësore të marrëveshjeve shumëpalëshe të paraqitura në aneksin IV.

Për qëllimet e kësaj Marrëveshjeje, termi "pronësi intelektual" do të përfshijë në mënyrë të veçantë të drejtën e autorit, duke futur këtu edhe të drejtën e autorit mbi programet kompjuterike, si dhe të drejtat fqinje, patentat, markat tregtare, dizenjot industriale, treguesit gjeografikë, topografikë e qarqeve të integruar, informacionin konfidencial, si dhe konkurrencën e pandershme.

2. Në përmbushje të angazhimeve të tyre si rezultat i marrëveshjeve ndërkombëtare dhe legjislationit në fushën e të drejtave të pronësisë intelektuale, Palët Kontraktuese në këtë Marrëveshje nuk duhet t'u japin shtetasve të Palës tjetër një trajtim më pak të favorshëm nga ai që u është akorduar shtetasve të çdo shteti tjetër të tretë.

3. Palët Kontraktuese duhet të bashkëpunojnë në çështjet intelektuale. Me kërkesën e një Pale Kontraktuese, ato duhet të kryejnë konsultime ekspertësh mbi këto çështje, në veçanti për aktivitetet

që lidhen me konventat ekzistuese ose me konventat e ardhshme ndërkombëtare për harmonizimin, administrimin dhe respektimin e të drejtave të pronësisë intelektuale, si dhe për aktivitetet në organizatat ndërkombëtare, të tilla si OBT, Organizata Botërore e Pronësisë Intelektuale, si edhe për marrëdhëniet e Palëve Kontraktuese me një shtet të tretë mbi çështjet e pronësisë intelektuale.

4. Zbatimi i këtij neni do të shqyrtohet rregullisht nga Palët Kontraktuese. Në rast vështirësish në tregti lidhur me të drejtat e pronësisë intelektuale, secila nga Palët Kontraktuese mund të kërkojë konsultime urgjente për të gjetur zgjidhje reciproke të kënaqshme.

Neni 30

Prokurimi publik

1. Palët Kontraktuese e konsiderojnë liberalizimin e tregjeve të tyre të prokurimit publik si një objektiv të kësaj marrëveshjeje. Palët synojnë hapjen e aksesit në kontratat publike mbi bazat e jodiskriminimit dhe reciprocitetit.

2. Palët Kontraktuese do të zhvillojnë në mënyrë progresive rregullat e tyre përkatëse, kushtet dhe praktikat mbi prokurimin publik dhe do t'u japin furnizimeve të Palës tjetër Kontraktuese akses në procedurat e fitimit të kontratave në tregjet e tyre përkatëse të prokurimit publik, akses i cili nuk është më pak i favorshëm se ai i dhënë kompanive të çdo vendi tjetër të tretë.

3. Komiteti i Përbashkët do të ekzaminojë zhvillimet lidhur me arritjen e objektivave të këtij neni dhe mund të rekomandojë modalitete praktike të zbatimit të dispozitave të paragrafit 2, me qëllim që të sigurojë akses të lirë, transparencë dhe balancim të plotë të të drejtave dhe detyrimeve. Gjatë ekzaminimit të referuar në këtë paragraf prej këtij neni, Komiteti i Përbashkët mund të konsiderojë, veçanërisht nën dritën e rregullimeve ndërkombëtare në këtë fushë, mundësinë e zgjerimit të mbulimit dhe me shkallën e hapjes së tregut sipas paragrafit 2.

Palët Kontraktuese do të sillen që të aderojnë në Marrëveshjet e rëndësishme të negociuara sipas GATT 1994 dhe Marrëveshjes së Marrakeshit që themeloi OBT-në.

Neni 31

Shërbimet dhe investimet

Palët Kontraktuese e kësaj Marrëveshjeje e njohin rëndësinë në rritje të disa fushave, të tilla si shërbimet dhe investimet. Në përpjekjet e tyre për të zhvilluar gradualisht dhe për të zgjeruar bashkëpunimin e tyre, në veçanti në kontekstin e integritit evropian, ata do të bashkëpunojnë me synimin për të arritur një liberalizim progresiv dhe hapje të dyanëshme të tregjeve të tyre për investime dhe tregtinë në shërbime duke patur parasysh dispozitat përkatëse të Marrëveshjes së përgjithshme në tregtinë e shërbimeve.

Palët Kontraktuese do të diskutojnë në Komitetin e Përbashkët këtë bashkëpunim me qëllim zhvillimin dhe thellimin e lidhjeve midis tyre, të udhëhequr nga ky nen.

Neni 32

Komiteti i përbashkët

Një Komitet i Përbashkët themelohet këtu, në të cilin çdo Palë Kontraktuese do të përfaqësohet, Komiteti do të udhëhiqet nga dy Bashkëkryetarë. Bashkëkryetari nga secila Palë do të jetë ministri përgjegjës për tregtinë. Komiteti i Përbashkët do të përbëhet nga pesë anëtarë nga secila Palë Kontraktuese.

Komiteti i Përbashkët do të jetë përgjegjës për administrimin e kësaj Marrëveshjeje dhe do të sigurojë zbatimin e duhur të saj.

Me qëllim të një zbatimi të duhur të kësaj Marrëveshjeje, Palët Kontraktuese duhet të shkëmbejnë informacion dhe, sipas kërkesës së secilës nga Palët, duhet të kryejnë konsultime brenda Komitetit të Përbashkët. Komiteti duhet të mbajë nën konsideratë mundësinë e heqjes së mëtejshme të të gjitha pengesave ndaj tregtisë mes Palëve Kontraktuese. Komiteti i Përbashkët mundet të marrë vendime, në përputhje me dispozitat e paragrafit 3 të nenit 33, në rastet që parashikohen në këtë Marrëveshje. Për çështjet e tjera Komiteti mund të japë rekomandime.

Neni 33

Procedurat e Komitetit të Përbashkët

Për implementimin e duhur të kësaj Marrëveshjeje, Komiteti i Përbashkët do të takohet kurdoherë që të jetë e nevojshme, por së paku një herë në vit. Secila nga Palët mund të kërkojë të mbahet një takim i Komitetit.

Komiteti i Përbashkët duhet të veprojë me marrëveshje të përbashkët.

Në rast se një përfaqësues i Komitetit të Përbashkët të një Pale Kontraktuese të kësaj marrëveshjeje e ka pranuar një vendim, subjekt i përmbushjes së kërkesave ligjore të brendshme, atëherë vendimi duhet të hyjë në fuqi, në rast se nuk ka ndonjë datë të mëvonshme të përmbajtjes aty, në ditën që heqja e rezervimit (rezervës) notifikohet.

Komiteti i Përbashkët duhet të adaptojë rregullat e tij të procedurës, të cilat duhet, nga ana e tyre (inter alia), të përmbajnë dispozita për mbajtjen e takimeve dhe për caktimin e një kryetari dhe të kohës së tij/saj të kryesisë.

Komiteti i Përbashkët mund të vendosë të ngrejë nënkomitetet dhe grupe pune, në rast se e sheh të nevojshme, në mënyrë që ato ta ndihmojnë për të përmbushur detyrat e tij.

Neni 34

Përjashtime sigurie

Asgjë në këtë Marrëveshje nuk duhet të ndalojë një Palë në marrjen e masave të cilat ajo i konsideron të nevojshme:

a) për të parandaluar daljen e informacionit që bie në kundërshtim me interesat e tij thelbësore të sigurisë;

b) për mbrojtjen e interesave të saj thelbësore të sigurisë ose për implementimin e detyrimeve ndërkombëtare ose politikave kombëtare:

(i) në lidhje me trafikun e armëve, municionit dhe shtesave të luftës, duke siguruar që këto masa nuk i bëjnë të pabarabarta kushtet e konkurrencës në lidhje me produktet që nuk janë të destinuara për qëllime specifike ushtarake, si dhe të trafikut të tillë në mallra të tjera, në materiale dhe shërbime që kryhen drejtpërsëdrejti ose indirekt për qëllimet e furnizimit të një ndërmarrje ushtarake; ose në lidhje me mospërhapjen e armëve biologjike dhe kimike, e armëve bërthamore e pjesëve eksplozive bërthamore; ose

(ii) të marra në kohë lufte ose në tensione të tjera serioze ndërkombëtare, që përbëjnë rrezik lufte.

Neni 35

Përmbushja e detyrimeve

Palët Kontraktuese duhet të marrin të gjitha masat e nevojshme për të siguruar arritjen e objektivave dhe përmbushjen e detyrimeve të kësaj Marrëveshjeje.

Në rast se ndonjera nga Palët konsideron që Pala tjetër ka dështuar që të përmbushë këtë detyrim sipas kësaj Marrëveshjeje, Pala e interesuar mund të marrë masat e duhura sipas kushteve dhe në përputhje me procedurat e përcaktuara në nenin 23.

Neni 36

Klauzola zhvilluese

Kur një Palë Kontraktuese konsideron se mund të jetë e dobishme në interesin e ekonomive të Palëve Kontraktuese për të zhvilluar dhe thelluar marrëdhëniet e vendosura në këtë Marrëveshje, duke i zgjeruar ato në fusha që nuk janë mbuluar këtu, duhet t'i parashtrojë një kërkesë të arsyetuar Palës tjetër. Palët Kontraktuese mund të caktojnë Komitetin e Përbashkët për të ekzaminuar këtë kërkesë dhe, kur është e përshtatshme, për të bërë rekomandime ndaj tyre, veçanërisht me qëllim të hapjes së negociatave.

Neni 37
Amendamentet

Amendamente ndaj kësaj Marrëveshje, të tjera nga ato të vendosura në përputhje me paragrafin 3 të nenit 33, dhe të cilat janë aprovuar nga Komiteti i Përbashkët, duhet të jenë në fuqi në datën e marrjes së notës diplomatike të fundit, e cila konfirmon se të gjitha procedurat e kërkuara nga legjislacioni kombëtar i secilës Palë Kontraktuese për hyrjen në fuqi të amendamenteve janë përfunduar.

Neni 38
Protokollet dhe anekset

Anekset dhe protokollet e kësaj Marrëveshje janë një pjesë integrale e saj. Komiteti i Përbashkët mund të vendosë të amendojë shënimin e kuptimit, anekset dhe protokollet, nënakte të procedurave ligjore të brendshme të palëve Kontraktuese.

Neni 39
Vlefshmëria dhe tërheqja nga Marrëveshja

Marrëveshja përfundohet për një periudhë të pacaktuar.

Secila Palë Kontraktuese e kësaj Marrëveshje mund të tërhiqet prej saj me anë të një notifikimi të shkruar ndaj Palës tjetër. Pushimi i Marrëveshjes do të kryhet në ditën e parë të muajit të dytë që ndjek datën në të cilën notifikimi u mor nga Pala tjetër.

Palët Kontraktuese bien dakort që në rast të hyrjes së njëres prej Palëve në Marrëveshjen me Bashkimin Europian, Marrëveshja do të pushojë së ekzistuari në ditën përpara hyrjes në BE, pa kompensime të mëvonshme për Palën tjetër Kontraktuese.

Neni 40
Hyrja në fuqi

Kjo Marrëveshje është subjekt ratifikimi. Ajo hyn në fuqi në datën e marrjes së notës së dytë, me të cilën Palët Kontraktuese notifikojnë njëra-tjetrën nëpërmjet kanaleve diplomatike se ato e kanë ratifikuar Marrëveshjen.

Në dëshmi të dhënë këtu, Palët nënshkruese të autorizuara me fuqi të plotë, e kanë nënshkruar Marrëveshjen e tanishme.

Bërë kopje në Tiranë, në datën 29.3.2002 në gjuhët, shqip, maqedonisht dhe anglisht, secila prej tyre autentike me vlerë të njëjtë. Në rast mosmarrëveshjeje do të mbizotërojë teksti anglisht.

Për Qeverinë Shqiptare

Për Qeverinë Maqedone

PROTOKOLLI A
(referuar Nenit 12, paragrafi 2)

SHKËMBIMI I KONCENSIONEVE BUJQËSORE MIDIS REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE
REPUBLIKËS SË MAQEDONISË

Neni 1

Protokolli do të aplikohet për produktet që janë të specifikuara në Kapitullin II të kësaj Marrëveshje.

Neni 2

Detyrimet doganore të importeve të aplikueshme në Republikën e Maqedonisë për produktet e origjinuara në Republikën e Shqipërisë të listuara në aneksin 1 të këtij Protokolli, do të hiqen ose zvogëlohen brenda litimeve të kuotave të specifikuara në këtë aneks nga data e hyrjes në fuqi të kësaj Marrëveshjeje.

Neni 3

Detyrimet doganore të importeve të aplikueshme në Republikën e Shqipërisë për produktet e origjinuara në Republikën e Maqedonisë të listuara në aneksin 2 të këtij Protokolli do të hiqen ose zvogëlohen brenda litimeve të kuotave të specifikuara në këtë Aneks nga data e hyrjes në fuqi të kësaj Marrëveshjeje.

Neni 4

1. Detyrime bazë të rëna dakord sipas anekseve të këtij Protokolli janë normat detyruese të Kombit më të Favorizuar (KMF) të aplikueshme në datën e hyrjes në fuqi të kësaj Marrëveshjeje. Produktet që nuk janë përfshirë në anekset e këtij Protokolli, norma detyruese KMF do të aplikohet në momentin e importimit aktual. Detyrimet doganore që i referohet ky Protokoll përfshijnë detyrime doganore ad valorem dhe specifike dhe detyrimet specifike të produktit.

2. Nëse, pas hyrjes në fuqi të kësaj Marrëveshjeje, do të aplikohet ndonjë reduktim tarifar mbi bazën erga omnes, detyrime të tilla të zvogëluara do të zëvendësojnë detyrimet bazë të përcaktuara në paragrafin 1 të këtij neni, nga data kur reduktimet të tilla fillojnë të aplikohen.

Neni 5

1. Komiteti i Përbashkët referuar nenit 32 të kësaj Marrëveshjeje do të përcaktojë limitet e kuotave të përvitshme, të paktën një muaj para fillimit të vitit të ri kalendarik, dhe ato do të shpërndahen jo më shumë se dy herë në vit duke marrë parasysh karakterin sezonal të produkteve.

2. Kur vendosen kuotat e këtij Protokolli, kuotat mund të jenë më të larta ose më të ulta se ato të vitit të mëparshëm. Listat e koncensioneve mund të zgjerohen me marrëveshje të përbashkët.

3. Palët Kontraktuese do të njoftojnë njëri-tjetritin për shpërndarjen e kuotave nga listat e koncensioneve jo më vonë se 1 muaj pasi është bërë shpërndarja.

4. Për qëllim të sigurimit të funksionimit të duhur të dispozitave të Protokollit A të kësaj Marrëveshjeje dhe mundësive për t'i dhënë njeri-tjetrit koncensione të mëtejshme, Palët Kontraktuese do të zhvillojnë rregullisht konsultime në bazë të interesit të përbashkët në kuadrin e punës së Komitetit të Përbashkët.

PROTOKOLLI A , ANEKSI 1

Importi i produkteve bujqësore dhe ushqimore të përpunuara në Republikën e Maqedonisë me origjinë nga Republika e Shqipërisë të cilat do të jenë subjekt i koncensioneve të mëposhtme

1. Lista e produkteve bujqësore dhe ushqimore të përpunuara bilaterale, me origjinë nga Republika e Shqipërisë të cilat do të importohen në Republikën e Maqedonisë duke përjashtuar pagesën e tarifave doganore, duke filluar nga data e hyrjes në fuqi të kësaj Marrëveshjeje.

Kodi tarifar	Përshkrimi
Tarifa doganore maqedonase	
0101	Kuaj, gomerë, mushka dhe hibrid të gomaricës me kalin, të gjalla
0101 10	-Kafshë të racës së pastër
0101 10 10 00	--Kuaj:
0101 10 90 00	-Të tjera:
0101 90	-Të tjera:

	--Kua
0101 90 19 00	---Të tjera
0101 90 30 00	---Gomerë:
0101 90 90 00	---Mushka dhe hibrid i gomaricës me kalin
0102	Gjethë të gjalla:
0102 10	-Kafshë të racës së pastër:
0102 10 10 00	-Prerje të tjera me kocka në të:
0102 10 30 00	--Viça (gjedhët femra që nuk kanë pjellë)
0102 10 90 00	--Të tjera
0102 90	-Të tjera:
	--Të llojit shtëpiakë:
0102 90 05 00	---Të një peshe jo më tepër se 80 kg
	----Të një peshe më tepër se 80 kg por jo më tepër se 160 kg:
0102 90 29 00	---Të tjera
0103	Derra të gjallë:
0103 10 00 00	-Kafshë të racës së pastër
	-Të tjera
0103 91	--Që peshojnë më pak se 50 kg:
0103 91 10 00	--Të llojit shtëpiak:
0103 91 90 00	---Të tjera
0104	Dele dhe dhi të gjalla:
0104 10	-Dele:
0104 10 10 00	Të racës së pastër
0104 20	--Të tjera
	-Dhi:
0104 20 10 00	-Të racës së pastër
0105	Shpendë të gjalla, domethënë, shpendët e llojit Gallus domesticus, rosa, pata, gjela deti e shpendë indie:
	-Që peshojnë jo më shumë se 185 g:
0105 11	--Shpendë të llojit Gallus domesticus:
	---Zogjtë femra prindër dhe gjyshër:
0105 11 11 00	----Tufa për ngrohje
	---Të tjera:
0105 11 91 00	----Tufa për ngrohje
0105 19	--Të tjera:
0105 19 20 00	---Pata
0105 19 90 00	---Rosa dhe shpendë indie
	-Të tjera
0105 92 00	---Shpendë të llojit Gallus Domesticus, me peshë jo më shumë se 2000 g
0105 99	--Të tjera
0106	Kafshë të tjera të gjalla:
0205	Mish i kuajve, gomerëve, mushkave e hibridit të gomaricës me kalin, i freskët, i ftohtë apo i ngrirë:
0206	Të brendshmet e ngrënshme të gjedhëve, derrave, deleve, dhive, kuajve, gomerëve, mushkave apo hibridit të gomaricës me kalin, të freskëta, të ftohta apo të ngrira:
0206 10	-Prej gjedhëve, të freskëta apo të ftohta:
	-Prej gjedhëve të ngrira:
0206 21 00 00	--Gjuh
0206 22 00 00	--Mëlçi:
0206 30	Prej derrave, të freskëta apo të ftohta:
	-Prej derrave, të ngrira:
0206 41	-Mëlçi
0206 49	--Të tjera:
0206 80	-Të tjera, të freskëta apo të ftohta:
0206 90	-Të tjera, të ngrira:
0208	Mish tjetër e të brendshmet e ngrënshme të tij, të freskëta, të ftohta apo të ngrira:
0210	Mishi e të brendshmet e ngrënshme të mishit, të kriposura, në ujë me kripë, të thara apo të tymosura; pudër e ngrënshme e mishit e të brendshmëve të mishit:
	-Të tjera, përfshirë miellrat e pudrat e ngrënshme të mishit e të të brendshmëve të mishit:
0210 91 00 00	--Prej kafshëve prejhistorike
0210 92 00 00	--Prej balenash, delfinësh dhe gjitarësh (gjitarë deri të llojit CATACEA), gjitar vertebror bimë ngrënës dhe dugongs (gjitarë deti të llojit SIRENIA)
0210 93 00 00	Prej zvarranikësh (përfshirë gjarpurin dhe breshkën e ujit)
0210 99	--Të tjera
0404	Hirrë, nëse është apo jo e koncentruar apo që përmban sheqer shtesë apo lëndë të tjera ëmbëlsuese; produktet që përbëhen nga përbërës të qumështit natyral, nëse përmbajnë apo jo sheqer shtesë apo lëndë të tjera ëmbëlsuese, të papërfshira apo të paspecifikuara diku tjetër:
0408	Vezët e zogjve, jo në guackë, e të verdhat e vezëve, të freskëta, të thara, të gatuar në avull apo nga

	zierja në ujë, të dhëna formë, të ngrirë apo të ruajtur ndryshe, nëse përmbajnë apo jo sheqer shtesë apo lënde të tjera ëmbëlsuese shtesë:
0410	Produkte të ngrënshme me origjinë prej kafshëve, të papërfshira e të paspecifikuara diku tjetër.
0501	Flokët e njerëzve, të papunuara, nëse janë apo jo të lara apo të pastruara; mbetje të flokëve të njerëzve.
0502	Qimet e kreshtat e derrave të butë, të derrave të egër; qimet e baldosave e qime të tjera për bërjen e furcave; mbetjet e qimeve apo kreshtave të tillë:
0503	Flokët e kalit e mbetjet e flokëve të kalit, nëse janë vendosur apo jo në shtresa me apo pa materiale të tjera mbështetëse
0504	Të brendshmet, fshikëzat e stomaqet e kafshëve (përveç atyre të peshkut), të plota e pjesë prej tyre, të freskëta, të ftohta, të ngrira, të kripura, në ujë me kripë, të thara apo të tymosura
0505	Lëkurët e zogjve e pjesë të tjera të zogjve, me puplat e pushin e tyre, puplat e pjesët e puplave (nëse janë apo jo të zbkuruara në anët) e pushi, jo më tej të punuara përveçse të pastruara, të disinfektuara apo të trajtuar ndryshe për ruajtje; pluhura e mbetje të puplave apo të pjesëve të puplave;
0506	Kockat dhe palca e brirëve, të papunuara, të çyndyrosura, thjesht të përgatitura (pot jo të prera në forma), të trajtuara me acid apo të dexhelatinuara; pluhura dhe mbetje të këtyre produkteve;
1905	Bukë, torta, kek, biskotat e produkte të tjera të furrëtarit, nëse përmbajnë apo jo kakao; nafore. Hapet (kapsulat) bosh të një lloji të përshtatshme për qëllime farmaceutike, vafer me shtresa, letër orizi e produkte të ngjashme
2009	Lëngje frutash (përfshirë mushtin e rrushit) e lëngje zarzavatesh, të pafermentuara e që nuk përmbajnë lëndë alkoolike shtesë, nëse përmbajnë sheqer apo lëndë të tjera ëmbëlsuese shtesë.
2204	Verë prej rrushit të freskët, përfshirë verërat e pasuruara me alkool; musht rrushi përveç atij të kreut Nr.2009

PROTOKOLLI B
PËRKUFIZIMI I KONCEPTIT TË ORIGINËS SË PRODUKTEVE
DHE METODAT E BASHKËPUNIMIT ADMINISTRATIV

Përmbajtja e tabelës

KREU IDISPOZITAT E PËRGJITHSHME

- Neni 1Përkufizimet

KREU IIPËRKUFIZIMI I KONCEPTIT “PRODUKTET ME ORIGINË”

- Neni 2Kërkesa të përgjithshme
- Neni 3Akumulimet në Republikën e Maqedonisë
- Neni 4Akumulimet në Republikën e Shqipërisë
- Neni 5Përfitimi i plotë i produkteve
- Neni 6Produkte të punuarA apo përpunuar mjaftueshëm
- Neni 7Punime ose operacione përpunimi të pamjaftueshme
- Neni 8Njësitë e kualifikimit
- Neni 9Aksesorët, pjesët e këmbimit dhe instrumentet
- Neni 10Vendosjet
- Neni 11Elementët neutralë

KREU IIKËRKESAT TERRITORIALE

- Neni 12Principet e territorialitetit
- Neni 13Transporti indirekt
- Neni 14Ekspozimet

KREU IVTËRHEQJA E PËRJASHTIMEVE

- Neni 15Ndalimet e tërheqjeve nga, ose përjashtimeve nga detyrimet doganore

KREU VDEMONSTRIMI I ORIGINËS

- Neni 16Kërkesa të përgjithshme
- Neni 17Procedurat për dhënien e një certifikate lëvizjeje EUR.1
- Neni 18Certifikatat e një certifikate lëvizjeje të dublikuar EUR.1
- Neni 20Nxjerrja e një certifikate lëvizjeje EUR. 1 mbi bazën e certifikatës së origjinës të lëshuar apo bërë më parë

- Neni 21Kushte për prodhimin e një deklarate invoice
- Neni 22Eksportuesi i miratuar
- Neni 23Vlefshmëria e deklaratës së origjinës
- Neni 24Depozitimi i deklaratës së origjinës
- neni 25Importimet me dërgesë të parë
- Neni 26Përjashtimet nga deklarata e origjinës
- Neni 27Dokumentet mbështetëse
- Neni 28Ruajtja e deklaratës së origjinës dhe dokumentet mbështetëse
- Neni 29Mospërputhjet dhe gabimet formale
- Neni 30Shumat e shprehura në euro

KREU VIRREGULLIMET PËR BASHKËPUNIM ADMINISTRATIV

- Neni 31Asistenca reciproke
- Neni 32Verifikimi i deklaratave të origjinës
- Neni 33Zgjidhja e mosmarrëveshjeve
- Neni 34Penalitetet
- Neni 35Zonat e lira

KREU VIIPROVIZIONET FINALE

- Neni 36Nënkomiteti për Çështjet e Doganave dhe Origjinës
- Neni 37Amendimet në Protokoll

KREU I DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1 Përkufizimet

Për qëllimet të këtij Protokolli:

(a) “përpunim” do të thotë çdo lloj punimi ose procesi, duke përfshirë operacione tërësore ose specifike;

(b) “material” do të thotë çdo lloj përbërësi, material i parë, përbërës ose pjesë, etj., të përdorura në prodhimin e produktit;

(c) “produkt” do të thotë produkti që është përpunuar, madje edhe nëse synohet që ai të përdoret për përdorim të mëtejshëm në operacione të tjera përpunimi;

(d) “produktet” përfshin së bashku materialet dhe produktet;

(e) “vlera doganore” do të thotë vlera e përcaktuar në përputhje me Marrëveshjen mbi implementimin e nenit VII të Marrëveshjes së përgjithshme mbi tarifën dhe tregtinë GATT 1994 (Marrëveshja e OBT-së mbi vlerësimin doganor);

(f) “çmimi” do të thotë çmimi i paguar për çmimin e fabrikës së produktit të përpunuar në Republikën e Maqedonisë ose në Republikën e Shqipërisë, në të cilin është ndërmarrë punimi ose procesi më i fundit që është kryer, që sigurojnë që çmimi përfshin vlerën e të gjithë materialeve të përdorura, minus ndonjë taksë, të brendshme, të cilat janë ose mund të jenë ripaguar kur produkti eksportohet;

(g) “vlera e materialeve me origjinë” do të thotë vlera e doganore në kohën e importimit të materialeve të përdorura jo të origjinuara ose, nëse kjo nuk është e njohur dhe nuk mund të përcaktohet, çmimi i parë i përcaktuar i paguar për materialet në Republikën e Maqedonisë ose Republikën e Shqipërisë;

(h) “vlera e materialeve me origjinë” do të thotë vlera e materialeve të tilla siç është përcaktuar në nënparagrafin (g) me alternativa të nevojshme të aplikuara;

(i) “kapituj” dhe “krerë” do të thotë kapitujt dhe krerët (kodet katër-shifrore) të përdorura në nomenklaturë, të cilat përbëjnë përshkrimin e harmonizuar të mallrave dhe Sistemin e Kodeve, referuar në këtë Protokoll si “Sistemi i Harmonizuar” ose “HS”;

(k) “i klasifikuar” i referohet klasifikimit të një produkti ose materiali nën një kre të veçantë;

(l) “dërgesa” do të thotë produkte që janë dërguar në mënyrë simulante nga një eksportues të një dërgues ose të shoqëruara me një dokument të vetëm transporti, që mbulon transportimin e tyre nga një eksportues të një dërgues ose, në mungesë të një dokumenti të tillë, nga një zë i vetëm;

(m) “territore” përfshijnë ujërat territoriale.

KREU II PËRKUFIZIMI I KONCEPTIT “ORIGJINA E PRODUKTEVE”

Neni 2 Kërkesa të përgjithshme

1. Për qëllime të implementimit të kësaj Marrëveshjeje, produktet e mëposhtme do të konsiderohen me origjinë nga Republika e Maqedonisë:

a) produkte tërësisht të përfituara në Republikën e Maqedonisë, në përputhje me nenin 5 të këtij Protokolli;

b) produkte të përfituara në Republikën e Maqedonisë, që përfshijnë materiale që nuk kanë qenë tërësisht të përfituara atje, sigurojnë që materiale të tilla kanë kaluar në punime apo procese të mjaftueshme në Republikën e Maqedonisë në përputhje me nenin 6 të këtij Protokolli;

2. Për qëllime të implementimit të kësaj Marrëveshjeje, produktet e mëposhtme do të konsiderohen me origjinë nga Republika e Shqipërisë.

(a) produktet tërësisht të përfituara në Republikën e Shqipërisë në përputhje me nenin 5 të këtij Protokolli;

(b) produkte të përfituara në Republikën e Maqedonisë, që përfshijnë materiale që nuk kanë qenë tërësisht të përfituara atje, sigurojnë që materiale të tilla kanë kaluar në punime apo procese të mjaftueshme në Republikën e Shqipërisë në përputhje me nenin 6 të këtij Protokolli.

Neni 3

Akumulimi bilateral në Republikën e Maqedonisë

Materialet me origjinë nga Republika e Shqipërisë do të konsiderohen si materiale me origjinë nga Republika e Maqedonisë kur përfshihet një produkt i përfituara atje. Nuk do të jetë e nevojshme që materiale të tilla, që kanë kaluar nën punime apo procese të mjaftueshme, të sigurojnë që kanë kaluar në punime apo procese përtej atyre që u referohet neni 6 (1).

Neni 4

Akumulimi bileateral në Republikën e Shqipërisë

Materialet me origjinë nga Republika e Maqedonisë do të konsiderohen si materiale me origjinë nga Republika e Shqipërisë kur përfshihet një produkt i përfituara atje. Nuk do të jetë e nevojshme që materiale të tilla, që kanë kaluar nën punime apo procese të mjaftueshme, të sigurojnë që kanë kaluar nën punime apo procese përtej atyre që u referohet neni 6 (1).

Neni 5

Produkte tërësisht të përfituara

1. Produktet e mëposhtme do të konsiderohen si tërësisht të përfituara në Republikën e Maqedonisë ose të Shqipërisë:

- (a) produkte minerale të nxjerra nga vaji ose nga farërat e tyre;
- (b) produkte bimore të korrura atje;
- (c) kafshët e gjalla të lindura dhe të rritura atje;
- (d) produkte nga kafshët e gjalla të rritura atje;
- (e) produkte të përfituara nga gjuetia apo peshkimi të kryera atje;
- (f) produkte të peshkimit ose produkte të tjera të marra nga deti jashtë ujërave territoriale të Republikës së Maqedonisë ose Republikës së Shqipërisë nga barkat e tyre;
- (g) produkte të prodhuara jashtë fabrikave të tyre ekskluzivisht nga produktet e referuara në nënparagrafin (f);
- (h) artikujt e përdorur, të mbledhur atje, që përshtaten vetëm për mbulimin e lëndëve të para, duke përfshirë gomat e përdorura të përshtatshme vetëm për ritrajtim ose që përdoren si mbetje;
- (i) mbetje dhe skrape të rezultuara nga operacionet e përpunimit të kryera atje;
- (j) produkte të nxjerra nga territori i marinës ose nënterritorët jashtë ujërave të tyre territoriale, duke siguruar që ata kanë të drejtën ekskluzive për ta punuar atë territor apo nënterritor;
- (k) mallra të prodhuara atje ekskluzivisht nga produktet e specifikuar në nënparagrafin (a) të (j).

2. Termi “barkat e tyre” dhe fabrikat e tyre” në paragrafin 1(f) dhe (g) do të aplikohen vetëm për barkat dhe fabrikat:

- (a) të cilat janë të regjistruara ose të mbajtura në Republikën e Maqedonisë dhe në Republikën e Shqipërisë;
- (b) të cilat lundrojnë nën flamurin e Republikës së Maqedonisë ose të Republikës së Shqipërisë;
- (c) të cilat janë në pronësi të mbi të paktën 50 për qind nga vendasit e Republikës së Maqedonisë ose të Republikës së Shqipërisë, ose nga një kompani me zyrat e saj kryesore në një nga këto shtete, ku menaxheri ose menaxherët, Kryetari i Bordit të Drejtorëve ose Bordi Supërvizor dhe shumica e anëtarëve të bordeve të tilla janë vendas të Republikës së Maqedonisë ose të Republikës së Shqipërisë dhe të cilët, në shtesë, në rastin e bashkëpronësisë ose kompanive të kufizuara, të paktën gjysma e kapitalit i përket këtyre shteteve ose institucioneve publike ose vendasve të shteteve të mësipërme;
- (d) e të cilit pronari ose zyrtarët janë vendas të Republikës së Maqedonisë ose të Republikës së

Shqipërisë; dhe

(e) e të cilit të paktën 75 për qind e ekuipazhit janë vendas të Republikës së Maqedonisë ose të Republikës së Shqipërisë.

Neni 6

Produkte të punuar ose të kaluar në proces mjaftueshëm

1. Për qëllime të nenit 2, produktet të cilat nuk janë tërësisht të përfituara konsiderohen të punuara ose të kaluara në proces të mjaftueshëm, kur kushtet e vendosura në listën e aneksit II janë plotësuar. Kushtet e referuara treguesit të mësipërm, për të gjithë produktet që mbulon kjo Marrëveshje, punimi ose proceset nën të cilat do të kalojnë materialet jo të origjinuara të përdorura në përpunim dhe aplikohen vetëm në lidhje me materiale të tilla. Përkatësisht, nëse një produkt i cili ka kërkuar statusin e origjinës duke plotësuar kushtet e vendosura në listë përdoret në përpunimin e një produkti tjetër, kushtet e aplikuar në një produkt në të cilin është bashkuar nuk aplikohen në të dhe asnjë llogari nuk do të merret në materialet jo të origjinuara, të cilat mund të jenë përdorur në përpunimin e tij.

2. Pavarësisht nga paragrafi 1, materialet jo të origjinuara, të cilat, sipas kushteve të vendosura në listë, nuk do të përdoren në përpunimin e një produkti, megjithatë mund të përdoren, sigurojnë që:

vlera e tyre totale nuk i kalon 10 për qind të çmimit të fabrikës së produktit;

(b) ndonjë nga përqindjet e dhëna në listë për maksimumin e vlerës së materialeve jo të origjinuara nuk tejkalohen përmes aplikimit të këtij paragrafi.

Ky paragraf nuk do të aplikohet për produktet që bien nga kapitulli 50 në 63 të sistemit të harmonizuar.

3. Paragrafi 1 dhe 2 do të aplikohen me përjashtimin e dhënë në nenin 7.

Neni 7

Operacionet e punimeve ose proceseve të pamjaftueshme

1. Pavarësisht nga paragrafi 2, operacionet e mëposhtme do të konsiderohen si punime ose procese të pamjaftueshme për t'iu konfirmuar statusi i origjinës së produktit, nëse po ose jo kërkesat e nenit 6 janë plotësuar:

(a) kryerja e operacioneve që sigurojnë që produkti të jetë në kushte të mira gjatë transportit dhe magazinimit;

(b) prerjet dhe bashkimet e paketimeve;

(c) larja, pastrimi, heqja e mbeturinave, oksideve, vajit, njollave apo mbetjeve të tjera;

(d) hekurosja ose presimi i tekstileve;

(e) operacionet e thjeshta të lyerjeve apo shkëlqimit;

(f) tharja e lëvozhgave, tharja në diell ose me procese kimike tërësore ose pjesore, shkëlqimi dhe ndriçimi i farërave dhe orizit;

(g) operacionet e ngjyrosjes së sheqerit ose dhënia e formave të ndryshme të sheqerit;

(h) qërimi, pastrimi i pjesës së brendshme të frutave, perimeve dhe lajthive, arave, bajameve;

(i) ndarjet, bluarjet ose prejet e thjeshta;

(j) heqja e pjesëve mbuluese, mbrojtja nga dëmtuesit e jashtëm, përzgjedhjet, klasifikimi, përshkallëzimet dhe matjet (duke përfshirë vendosjen e pjesëve të artikujve);

(k) thjesht, vendosjet në shishe, kanaçe, epruveta, çanta, valixhe, kuti, sirtare, fiksimi në to i letrave ose mbështjellësve, si dhe gjithë operacionet e tjera të thjeshta të paketimit;

(l) fiksimi ose printimi i markave, etiketave, logove, si dhe shenjave të tjera të dallueshme mbi produkte ose mbi paketimin e tyre;

(m) përzierja e thjeshtë e produkteve, nëse po ose jo i llojeve të ndryshme;

(n) bashkimi i thjeshtë i pjesëve të artikujve për të përfunduar një material të plotë ose ndarja e produktit në pjesë;

(o) kombinimi i dy ose më shumë operacioneve të specifikuara në nënparagrafët nga (a) në (n);

(p) vrasja e kafshëve për ushqim, lëkurë ose për shkak të sëmundjeve të tyre.

2. Të gjitha operacionet që kryhen ose në Republikën e Maqedonisë ose në Republikën e

Shqipërisë mbi një produkt të caktuar do të konsiderohen së bashku kur të përcaktohet nëse punimet ose proceset mbi të cilat ka kaluar produkti do të konsiderohen si të mjaftueshme brenda kuptimit të paragrafit 1.

Neni 8

Njësitë e kualifikimit

1. Njësia e kualifikimit për aplikimin e dispozitave të këtij Protokolli do të jetë produkti i veçantë, i cili konsiderohet si njësi bazë kur për përcaktimin e klasifikimit përdoret nomenklatura e Sistemit të Harmonizuar.

Përkatesisht, procedohet përsa më poshtë:

(a) kur një produkt i përbërë nga një grup ose bashkim artikujsh është i klasifikuar nën termat e Sistemit të Harmonizuar në një kre të vetëm, e tëra përbën njësinë e klasifikimit;

(b) kur një bashkim përbëhet nga një numër produktesh identike të klasifikuara nën një kre të njëjtë të Sistemit të Harmonizuar, çdo produkt duhet të merret individualisht kur aplikohen dispozitat e këtij Protokolli.

2. Kur, nën rregullin e përgjithshëm 5 të Sistemit të Harmonizuar, paketimi përfshihet bashkë me produktin për qëllime klasifikimi, ai do të përfshihet për qëllim të përcaktimit të origjinës.

Neni 9

Aksesorët, pjesët e këmbimit dhe instrumentet

Aksesorët, pjesët e këmbimit dhe instrumentet të lidhura me një pjesë pajisjeje, makine, aparati apo mbulese, të cilat janë pjesë e një pajisjeje normale dhe, për më tepër përfshihen në çmim ose nuk janë të ndara dukshëm, do të konsiderohen si një me pjesën e pajisjes, makinës, aparatit ose mbulesave në fjalë.

Neni 10

Vendosjet

Vendosjet e përcaktuara në rregullin e përgjithshëm 3 të Sistemit të Harmonizuar do të konsiderohen të origjinuara kur të gjitha pjesët e komponentit janë me origjinë. Megjithatë, kur një vendosje përbëhet nga produkte të origjinuara dhe të jo origjinuara, vendosja në tërësi do të konsiderohet e origjinuar, duke siguruar që vlera e produkteve të jo origjinuara nuk i kalon 15 për qind e çmimit të fabrikës për vendosjet.

Neni 11

Elementët neutralë

Me qëllim që të përcaktohet nëse një produkt është i origjinuar, nuk është e nevojshme të përcaktohet origjina e të mëposhtmeve, të cilët mund të jenë përdorur gjatë prodhimit të tij:

energji dhe karburanti;

toka dhe pajisjet;

makineritë dhe mjetet;

d) mallrat të cilat nuk hyjnë dhe të cilat synohen të përfshihen në kompozimin final të produktit.

KREU III

KËRKESAT TERRITORIALE

Neni 12

Principet e territorialitetit

1. Kushtet për marrjen e statusit të origjinës, të vendosura në titullin II, duhet të vazhdojnë të plotësohen në çdo kohë në Republikën e Maqedonisë dhe në Republikën e Shqipërisë.

2. Nëse produktet e origjinuara të eksportuara nga Republika e Maqedonisë ose Republika e Shqipërisë në një vend tjetër janë kthyer, ato duhet të konsiderohen si jo të origjinuara, nëse nuk mund të demonstrohet mjaftueshëm te autoritetet doganore se:

mallrat e kthyer janë të njëjta me ato që janë eksportuar; dhe

(b) ato nuk kanë kaluar në ndonjë proces tjetër veçse atyre të nevojshme për t'i mbajtur në kushte të mira gjatë kohës që janë në atë vend ose gjatë kohës së eksportimit.

Neni 13

Transporti i drejtpërdrejtë

1. Trajtimi preferencial i siguar në Marrëveshje aplikohet vetëm për produktet që plotësojnë kërkesat e këtij Protokolli, të cilat janë transportuar direkt midis Republikës së Maqedonisë dhe Republikës së Shqipërisë. Sidoqoftë, produkte që përbëhen nga një bashkim i vetëm mund të transportohen nëpërmjet territoreve të tjerë me, nëse shqyrtohet çështja, lëvizje tranzit ose magazinim i përkohshëm në këto territore, duke siguruar që ato mbeten nën vëzhgimin e autoriteteve doganore të ngarkimit, ose ndonjë operacion tjetër, me synim për t'i mbajtur ato në kushte të mira.

2. Evidencat që kushtet e vendosura në paragrafin 1 janë plotësuar tërësisht duhet t'i jepen autoriteteve doganore të vendit importues nga paraqitja e:

(a) një dokumenti të vetëm transporti, që tregon kalimin nga vendi eksportues përmes vendit tranzit; ose

një certifikatë të lëshuar nga autoritetet doganore të vendit tranzit:

(i) një përshkrim i saktë i produkteve;

(ii) paraqitja e datave të shkarkimit dhe ngarkimit të produkteve dhe, nëse është e aplikueshme, emrat e anijeve ose llojet e tjera të transportit të përdorur; dhe

(iii) vërtetim i kushteve, nën të cilat ka qëndruar produkti në vendin tranzit:

nëse nuk mundësohen këto dokumente, ndonjë dokument tjetër thelbësor.

Neni 14

Ekspozitat

1. Produktet e origjinuara, të dërguara për ekspozim në një vend tjetër, veçse atij të Republikës së Maqedonisë dhe Republikës së Shqipërisë duhet të përfitojnë importimin sipas dispozitave të Marrëveshjes, duke siguruar që kënaq autoritetet doganore se:

(a) një eksportues ka dërguar këto produkte nga Republika e Maqedonisë ose Republika e Shqipërisë në vendin në të cilin do të zhvillohet ekspozita dhe i ka ekspozuar ato atje;

(b) produktet janë shitur ose nuk janë më në pronësi të eksportuesit, por të një personi në Republikën e Maqedonisë ose në Republikën e Shqipërisë;

(c) produktet janë dorëzuar gjatë ekspozitës ose menjëherë pas tij në shtetin në të cilin ato janë dërguar për ekspozim; dhe

(d) produktet nuk janë, që kur ato u dërguan në ekspozitë, përdorur për ndonjë qëllim tjetër veçse atij të ekspozimit.

2. Një certifikatë origjine duhet të jetë lëshuar ose bërë në përputhje me dispozitat e kreu V dhe i jepet autoriteteve doganore të vendit importues në mënyrë normale. Emri dhe adresa e ekspozitës duhet të tregohen në të. Kur është e nevojshme, mund të kërkojen evidenca dokumentare shtesë të kushteve nën të cilat ato janë ekspozuar.

3. Paragrafi 1 do të aplikohet në çdo lloj ekspozimi tregtar, industrial, bujqësor, ose pajisjesh, prezantim i thjeshtë publik ose panair ose paraqitje, e cila nuk është organizuar për qëllime private, dyqane ose biznese, me synim për t'i shitur produktet e huaja dhe gjatë së cilës produkti është nën kontrollin doganor.

KREU IV

TËRHEQJA E PËRJASHTIMIT

Neni 15

Ndalimi i tërheqjes së, ose përjashtimeve nga detyrimet doganore

1. Materialet jo të origjinuara të përdorura në prodhimin e një produkti të origjinuar nga Republika e Maqedonisë, nga Republika e Shqipërisë, për të cilat një evidencë e origjinës është lëshuar ose bërë në përuthje me dispozitat e kreut V nuk do të jenë në Republikën e Maqedonisë, në Republikën e Shqipërisë subjekt tërheqjeje te, përjashtimi nga detyrimet doganore të këtij lloji.

2. Ndalimi në paragrafin 1 do të aplikohet për çdo lloj rregullimi për rimbursim, anulimi i borxheve ose jopagesave, pjesore ose tërësore, të detyrimeve doganore ose detyrimeve të tjera me të njëjtin efekt, të aplikueshme në Republikën e Maqedonisë ose në Republikën e Shqipërisë për materialet e përdorura në prodhim dhe në produktet e mbuluara në paragrafin 1(b) më sipër, ku rimbursimet, anulime borxhesh ose jopagesa të tilla aplikohen, shprehimisht ose me efekt, kur produktet që përmbajnë materialet e mësipërme janë eksportuar dhe jo kur ato mbahen për përdorim shtëpijak atje.

3. Eksportuesi i produktit me një certifikatë origjine duhet të përgatitet të paraqesë në çdo kohë me kërkesën e autoriteteve doganore, të gjitha dokumentet e nevojshme që provojnë se asnjë tërheqje nuk është bërë në respekt të materialeve jo të origjinuara të përdorura në prodhimin e produkteve në fjalë dhe se të gjitha detyrimet doganore ose detyrimet e tjera me të njëjtin efekt të aplikueshme në të tilla materiale aktualisht kanë qenë paguar.

4. Dispozitat e paragrafëve nga 1 në 3, gjithashtu, do të aplikohen në përputhje me paketimin brenda kuptimit të nenit 8(2), aksesoret, pjesët e këmbimit dhe instrumentet brenda kuptimit të nenit 9 dhe produktet e përcaktuara në nenin 10, kur pajisje të tilla nuk janë të origjinuara.

5. Dispozitat e paragrafëve nga 1 në 4, do të aplikohen vetëm për materialet të cilat janë të llojit për të cilat aplikohet Marrëveshja. Për më tepër, nuk përjashtohet aplikimi i ndonjë sistemi të rimbursimit të eksporteve për produktet bujqësore, të aplikueshme për eksportet në përputhje me dispozitat e Marrëveshjes.

6. Pavarësisht nga paragrafi 1, Republika e Shqipërisë mund të aplikojë për tërheqje te, përjashtime nga, detyrimet doganore ose detyrime të tjera me të njëjtin efekt, të aplikueshme në materialet e përdorura në prodhimin e produkteve të origjinuara, subjekt i dispozitave të mëposhtme:

(a) një normë 5 për qind të detyrimit doganor do të mbahet për produktet e përfshira nga kapitulli 25 në 49 dhe 64 në 97 të Sistemit të Harmonizuar, ose norma të tilla më të ulta siç është në fuqi në Republikën e Shqipërisë;

(b) një normë 10 për qind e detyrimit doganor do të mbahet për produktet e përfshira nga kapitulli 50 në 63 të Sistemit të Harmonizuar, ose norma të tilla më të ulta, siç është në fuqi në Republikën e Shqipërisë.

Dispozitat e këtij neni do të aplikohen nga 1 janar 2003 dhe mund të rishikohen në marrëveshje të përbashkët.

KREU V CERTIFIKATA E ORIGINJES

Neni 16

Kërkesa të përgjithshme

1. Produktet e origjinuara nga Republika e Maqedonisë gjatë importimit në Republikën e Shqipërisë, dhe produktet e origjinuara nga Republika e Shqipërisë gjatë importimit në Republikën e Maqedonisë, do të përfitojnë nga kjo Marrëveshje me paraqitjen e ndonjë:

(a) certifikate lëvizjeje EUR.1, një formë e së cilës tregohet në aneksin III; ose

(b) në rastet e specifikuara në nenin 21(1), një deklaratë, teksti i së cilës tregohet në aneksin IV, e lëshuar nga eksportuesi për një zë, një notë shpërndarjeje ose ndonjë dokument tjetër tregtar, i cili përshkruan produktin në fjalë me detaje të mjaftueshme për të bërë të mundur identifikimin (këtu e më pas i referohet si “faturë deklarimi”).

2. Pavarësisht nga paragrafi 1, produktet e origjinuara në kuptimin e këtij protokolli në rastet e specifikuara në nenin 26, do të përfitojnë nga kjo Marrëveshje pa qenë e nevojshme të paraqesin ndonjë nga dokumentet e përmendur më sipër.

Neni 17

Procedurat për lëshimin e një certifikate lëvizjeje EUR.1

1. Një certifikatë lëvizjeje EUR.1 do të lëshohet nga autoritetet doganore të vendit eksportues pas aplikimit të bërë me shkrim nga eksportuesi ose, nën përgjegjësinë e eksportuesit, nga përfaqësuesi i tij i autorizuar.

2. Për këtë qëllim, eksportuesi ose përfaqësuesi i tij do të plotësojnë të dyja certifikatat e lëvizjes EUR.1 dhe formën e aplikimit, një shembull i së cilës tregohet në aneksin III. Këta formularë do të plotësohen në një nga gjuhët me të cilat kjo Marrëveshje është nënshkruar dhe në përputhje me dispozitat e ligjit vendas të vendit eksportues. Nëse ato janë të shkruara me dorë, ato do të plotësohen me bojë me germa kapitale. Përshkrimi i produkteve duhet të jepet në një kuti të rezervuar për këtë qëllim, pa lënë ndonjë vijë bosh. Kur kutia nuk është e plotësuar tërësisht, një vijë horizontale duhet të hiqet poshtë vijës së fundit të përshkrimit, përmes hapësirës boshe.

3. Eksportuesi që aplikon për marrjen e një certifikate lëvizjeje EUR.1 do të përgatitet për të paraqitur në çdo kohë, me kërkesën e autoriteteve doganore të vendit eksportues ku certifikata e lëvizjes EUR.1 është lëshuar, të gjitha dokumentet e nevojshme që provojnë statusin e origjinës së produktit në fjalë, si dhe plotësimin e kërkesave të tjera të këtij Protokolli.

4. Një certifikatë lëvizjeje EUR.1 do të lëshohet nga autoritet doganore të Republikës së Maqedonisë ose të Republikës së Shqipërisë nëse produktet në fjalë mund të konsiderohen të origjinuara nga Republika e Maqedonisë ose Republika e Shqipërisë dhe plotëson kërkesat e tjera të këtij Protokolli.

5. Autoritetet doganore kompetente në lëshimin e certifikatave të tilla do të ndërmarrin çdo hap të nevojshëm për të verifikuar statusin e origjinës së produkteve dhe plotësimin e kërkesave të tjera të këtij Protokolli. Për këtë qëllim, ato kanë të drejtë të kërkojnë çdo evidencë, si dhe të kryejnë ndonjë inspektim të llogarive të eksportuesit ose ndonjë kontroll tjetër që ata e konsiderojnë të nevojshme. Autoritetet doganore kompetente, në lëshimin e certifikatave të tilla, gjithashtu, do të sigurojnë se formularët e referuar në paragrafin 2 janë të plotësuar mirë. Në veçanti, ata do të kontrollojnë nëse hapësira e rezervuar për përshkrimin e produkteve është plotësuar në mënyrë të tillë që përjashton të gjitha mundësitë për shtesa false.

6. Data e lëshimit të një certifikate lëvizjeje EUR.1 do të tregohet në kutinë 11 të certifikatës.

7. Një certifikatë lëvizjeje EUR.1 do të lëshohet nga autoritetet doganore dhe do të bëhet e vlefshme tek eksportuesi sa më shpejt që eksportimi aktual është kryer.

Neni 18

Certifikatat e lëvizjes EUR.1, të lëshuara retrospektivisht

1. Pavarësisht nga neni 17(7), një certifikatë lëvizjeje EUR.1, përjashtimisht, mund të lëshohet pas eksportimit të produkteve, të cilëve iu referohet nëse:

(a) ajo nuk është lëshuar në kohën e eksportimit për shkak të gabimeve ose mungesave të pavullnetshme ose rrethanave të veçanta; ose

(b) është demonstruar pakënaqësia e autoriteteve doganore se një certifikatë lëvizjeje EUR.1 ishte lëshuar, po nuk është pranuar gjatë importimit për arsye teknike.

2. Për implementimin e paragrafit 1, eksportuesi duhet të tregojë, në aplikimin e tij, vendin dhe datën e eksportimit të produkteve, për të cilat certifikata e lëvizjes EUR.1 lëshohet dhe të tregojë arsyet për këtë kërkesë.

3. Autoritetet doganore mund të lëshojnë një certifikatë lëvizjeje EUR.1, retrospektivisht, vetëm pasi të jetë verifikuar se informacioni i dhënë nga eksportuesi në aplikim është i njëjtë me atë të dosjeve korresponduese.

4. Certifikata e lëvizjes EUR.1, lëshuar retrospektivisht, duhet të mbyllet me një nga frazat e mëposhtme:

“ISSUED RETROSPECIVELY”,

“SHËNOHET DUKSHËM”,

“DOPOLNITELNO IZDADENO”

5. Mbyllja e referuar në paragrafin 4 do të vendoset në kutinë “Shënime” të certifikatës së

lëvizjes EUR.1.

Neni 19

Lëshimi i një certifikate të dublikuar lëvizjeje EUR.1

1. Në rast vjedhjeje, humbjeje apo shkatërrimi të një certifikate lëvizjeje EUR.1, eksportuesi mund të aplikojë tek autoritetet doganore, të cilat kanë lëshuar atë, për një dublikim që bëhet në bazë të dokumenteve të eksportit në gjendjen e tyre.

2. Dublikmi i lëshuar në këtë mënyrë duhet të mbyllet me një nga fjalët e mëposhtme:

“DUPLICATE”

“DUPLIKATE”

“DUPLIKAT”

3. Shënimi i referuar në paragrafin 2 të vendoset në kutinë “Shënime” të certifikatës së dublikuar të lëvizjes EUR.1.

4. Dublikimi, i cili duhet të tregojë dhe datën e lëshimit të certifikatës origjinale të lëvizjes EUR, do të ketë fuqi që nga ajo ditë.

Neni 20

Lëshimi i certifikatës së lëvizjes EUR.1 në bazë të evidencës së origjinës e lëshuar ose bërë më parë

Kur produktet me origjinë janë vendosur nën kontrollin e një zyre doganore në Republikën e Maqedonisë ose në Republikën e Shqipërisë, mund të jetë e mundur të zëvendësohet evidenca origjinale e origjinës me një ose më shumë certifikata të lëvizjes EUR.1, për qëllime të dërgimit të të gjitha ose disa nga këto produkte diku brenda Republikës së Maqedonisë ose Republikës së Shqipërisë. Zëvendësimi me certifikatë (certifikata) të lëvizjes do të bëhet nga zyra doganore, nën kontrollin e së cilës janë këto produkte.

Neni 21

Kushtet për lëshimin e një fature deklarimi

Një faturë deklarimi, siç i referohet në nenin 16 (1)(b), mund të lëshohet:

nga një eksportues i miratuar në kuptimin e nenit 22; ose

(b) nga një eksportues i ndonjë dërgese të përbërë nga një ose më shumë paketime që përmbajnë produkte me origjinë, vlera totale e të cilave nuk i kalon euro 6 000.

2. Një faturë deklarimi mund të lëshohet nëse produktet në fjalë konsiderohen si produkte me origjinë nga Republika e Maqedonisë ose Republika e Shqipërisë dhe plotëson të gjitha kërkesat e tjera të këtij Protokollit.

3. Eksportuesi që lëshon deklaratë duhet të përgatitet të paraqesë në çdo kohë, me kërkesën e autoriteteve doganore të vendit eksportues, të gjitha dokumentet e nevojshme që provojnë statusin e origjinës së produkteve në fjalë, si dhe plotësimin e kërkesave të tjera të këtij Protokollit.

4. Një faturë deklarimi duhet të lëshohet nga eksportuesi duke shtypur, stampuar, ose printuar mbi deklaratë notën shpërndarëse ose ndonjë dokument tjetër tregtar, teksti i së cilës jepet në aneksin IV, duke përdorur një nga versionet linguistike të përcaktuara në atë aneks dhe në përputhje me dispozitat e ligjit vendas të vendit eksportues. Nëse deklarata është e shkruar me dorë, duhet të shkruhet me bojë në germa kapital.

5. Një faturë deklarimi duhet të ketë firmën origjinale të eksportuesit në tekstin e shkruar me dorë. Sidoqoftë, një eksportues, i miratuar në kuptimin e nenit 22, nuk do t'i kërkohej të nënshkruajë deklarata të tilla, duke siguruar që u paraqet autoriteteve doganore të vendit eksportues një deklaratë me shkrim ku pranon të gjitha përgjegjësitë për një deklaratë e cila e identifikon atë me atë që është nënshkruar me shkrim dore nga ai.

6. Një faturë deklarimi mund të bëhet nga një eksportues kur produktet me të cilat ai ka lidhje eksportohen, ose mbas eksportimit në kushtet në të cilat ai është paraqitur në vendin importues jo më vonë se dy vjet pas importimit të produkteve me të cilat ai është i lidhur.

Neni 22
Eksportuesi i miratuar

1. Autoritetet doganore të vendit eksportues mund të autorizojnë çdo eksportues që bën transportime të shpeshta të mallrave sipas kësaj Marrëveshjeje të lëshojë faturë deklarimi, pavarësisht nga vlera e produkteve në fjalë. Një eksportues që kërkon një autorizim të tillë, duhet të paraqesë, sipas kërkesave të autoriteteve doganore, të gjitha garancitë e nevojshme për të vërtetuar statusin e origjinës së produkteve, si dhe plotësimin e kërkesave të tjera të këtij Protokolli.

2. Autoritetet doganore mund të japin statusin e eksportuesit të miratuar, subjekt të çdo kushti që ato e konsiderojnë të përshtatshëm.

3. Autoritetet doganore do t'i japin eksportuesit të miratuar një numër autorizimi doganor, i cili do të shfaqet në faturë deklarimi.

4. Autoritetet doganore do të monitorojnë përdorimin e autorizimeve nga eksportuesi e miratuar.

5. Autoritetet doganore mund të tërheqin angazhimin në çdo kohë. Ata mund ta bëjnë këtë kur eksportuesi i miratuar, referuar paragrafit 1, nuk plotëson kërkesat, referuar paragrafit 2 ose e ka keqpërdorur autorizimin.

Neni 23
Vlefshmëria e certifikatës së origjinës

1. Një certifikatë origjine do të jetë e vlefshme për katër muaj nga dita e lëshimit në vendin eksportues dhe duhet dorëzuar brenda periudhës së përcaktuar tek autoritetet doganore të vendit importues.

2. Certifikatat e origjinës që i janë dorëzuar autoriteteve doganore të vendit importues, pas ditës së fundit për paraqitje e specifikuar në paragrafin 1, mund të pranohen me qëllim përfitimimi nga trajtimi preferencial, kur dështon paraqitja e dokumenteve nga data finale, përcaktimi bëhet në bazë të situatave përjashtimore.

3. Në rastet e tjera të paraqitjeve shumë të vonuara, autoritetet doganore të vendit importues mund ta pranojnë certifikatën e origjinës para datës finale të vendosur.

Neni 24
Paraqitja e certifikatës së origjinës

Certifikatat e origjinës duhet të paraqiten pranë autoriteteve doganore të vendit importues, në përputhje të plotë me procedurat që aplikohen në atë vend. Autoritetet e mësipërme mund të kërkojnë një përkthim të certifikatës së origjinës dhe, gjithashtu, mund të kërkojnë deklaratën e importit, që duhet t'i bashkëngjitet një deklarami që vërteton se produktet plotësojnë kushtet e kërkuara për implementimin e kësaj Marrëveshjeje.

Neni 25
Importi me dërgesë të parë

Kur, me kërkesën e importuesit dhe me kushtet e parashtruara nga autoritetet doganore të vendit importues, produktet e ndara ose jo, të grupuara në kuptimin e rregullit të përgjithshëm (2) të Sistemit të Harmonizuar që është në Seksionin XVI dhge XVII ose kërret nr.7308 dhe 9406, që janë importuar me dërgesë të parë, një certifikatë e vetme origjine për të tilla produkte duhet të paraqitet pranë autoriteteve doganore gjatë importimit të dërgesës së parë.

Neni 26
Përjashtimet nga certifikata e origjinës

1. Produktet e dërgura në paketime të vogla nga persona privatë tek personat privatë ose që janë pjesë e bagazheve personale të udhëtarëve do të pranohen si produkte me origjinë pa kërkuar paraqitjen e ndonjë certifikate origjine, nëse sigurohet se këto produkte nuk janë importuar për qëllime

tregtie dhe janë deklaruar se plotësojnë kërkesat e këtij Protokolli dhe aty ku nuk ka dyshim të vërtetësia e një deklarimi të tillë. Në rastin e produkteve të dërguara me postë, kjo deklaratë mund të bëhet në deklarimin doganor CN22/CN23 ose në një copë letër që do t'i aneksohet atij dokumenti.

2. Importet, të cilat janë të rastësishme dhe përbëjnë vetëm produkte për përdorim personal nga marrësi ose udhëtari ose familjarët e tyre, nuk do të konsiderohen si importe për qëllime tregtie nëse është e evidente nga natyra dhe sasia e produkteve se nuk ka qëllime tregtie për to.

3. Për më tepër, vlera totale e këtyre produkteve nuk duhet të tejkalojë euro 500 në rastin e pakove të vogla ose euro 1 200 në rastin e produkteve që janë pjesë e bagazheve personale të udhëtarëve.

Neni 27

Dokumentet mbështetëse

Dokumentet referuar në nenin 17(3) dhe 21(30), që përdoren për qëllime të vërtetimit se produktet e shoqëruara me një certifikatë lëvizjeje EUR.1 ose një faturë deklarimi mund të konsiderohen si produkte me origjinë nga Republika e Maqedonisë ose nga Republika e Shqipërisë dhe plotësojnë të gjitha kërkesat e tjera të këtij Protokolli, mund të konsiderohen midis të tjerave të mëposhtmet:

(a) evidencë direkte e proceseve të kryera nga eksportuesi ose ofruesi për të përfituar produktet në fjalë, që mbahen për shembull në llogaritë ose në librat e llogarisë së brendshme;

(b) dokumentet që vërtetojnë statusin e origjinës së materialeve të përdorura, të lëshuara ose të bëra në Republikën e Maqedonisë ose në Republikën e Shqipërisë ku këto dokumente përdoren në përputhje me ligjin vendas;

(c) dokumentet që vërtetojnë punimet ose proceset, në të cilat kanë kaluar materialet në Republikën e Maqedonisë ose në Republikën e Shqipërisë, të lëshuara ose të bëra në Republikën e Maqedonisë ose në Republikën e Shqipërisë, ku këto dokumente janë përdorur në përputhje me ligjin vendas;

(d) certifikata e lëvizjes EUR.1 ose fatura e deklarimit që vërtetojnë statusin e origjinës së materialeve të përdorura, të lëshuara ose të bëra në Republikën e Maqedonisë ose në Republikën e Shqipërisë, në përputhje me këtë Protokoll.

Neni 28

Ruajtja e certifikatës së origjinës dhe e dokumenteve mbështetëse

1. Eksportuesi që aplikon për marrjen e një certifikate lëvizjeje EUR.1 duhet t'i mbajë dokumentet referuar në nenin 17(3) për të paktën tre vjet.

2. Eksportuesi që bën një faturë deklarimi duhet të mbajë për të paktën tre vjet një kopje të kësaj deklaratë, si dhe dokumentet referuar në nenin 21(3).

3. Autoritetet doganore të vendit eksportues, që lëshojnë një certifikatë lëvizjeje EUR.1, duhet të mbajnë për të paktën tre vjet formularin e aplikimit referuar në nenin 17(2).

4. Autoritetet doganore të vendit importues duhet të mbajnë për të paktën tre vjet certifikatën e lëvizjes EUR.1, si dhe faturën e deklarimit që iu paraqiten atyre.

Neni 29

Mospërputhjet dhe gabimet formale

1. Gjetja e mospërputhjeve të vogla midis deklarimeve të bëra në certifikatën e origjinës dhe ato të bëra në dokumentet e paraqitura në zyrën doganore, për qëllime të kryerjes së formaliteteve për importimin e produkteve nga ky fakt, nuk do ta bëjnë certifikatën e origjinës së anulueshme ose të shmangshme, nëse është evidentuar se ky dokument i korrespondon produkteve të paraqitura.

2. Gabimet formale të dukshme, të tilla si gabime gjatë shtypjes në certifikatën e origjinës, nuk do të bëhen shkas që ky dokument të hidhet poshtë, nëse këto gabime nuk janë të tilla që të krijojnë dyshime në lidhje me korrektësinë e deklarimit të bërë në atë dokument.

Neni 30

Sasitë e shprehura në euro

1. Për aplikimin e dispozitave të nenit 21(1)(b) dhe nenit 26(3), në rastet kur produktet faturohen në një valutë tjetër veç euros, sasia në monedhën kombëtare të Republikës së Maqedonisë ose të Republikës së Shqipërisë, ekuivalente me sasitë e shprehura në euro, duhet të fiksohet çdo vit.

2. Një dërgesë malli duhet të përfitojë nga dispozitat e nenit 21(1)(b) dhe nenit 26(3), duke iu referuar valutës në të cilën është përgatitur fatura, sipas sasisë së fiksuar nga Republika e Maqedonisë ose nga Republika e Shqipërisë.

3. Sasitë për t'u përdorur në çdo lloj valute kombëtare duhet të jenë ekuivalente me atë valutë të sasive të shprehura në euro si në ditën e parë të punës së muajit tetor. Sasitë që duhen të komunikohen ndërmjet palëve kontraktuese deri më 15 tetor dhe duhet të aplikohen nga 1 janari i vitit që vjen.

4. Republika e Maqedonisë ose Republika e Shqipërisë mund të rrumbullakosin më lart ose më poshtë sasinë që rezulton nga konvertimi në monedhën e vet kombëtare të një sasive të shprehur në euro. Sasia e rrumbullakosur nuk duhet të ndryshojë nga sasia e rezultuar prej konvertimit me më shumë se 5%. Republika e Maqedonisë ose Republika e Shqipërisë mund të gjykojnë të pandryshuar ekuivalentin e tyre në monedhën kombëtare të një shume të shprehur në euro, në rast se gjatë kohës së rregullimit vjetor sipas paragrafit 3, konvertimi i asaj shume, përpara rregullimit, rezulton në një rritje më pak se 15% në ekuivalentin e monedhës kombëtare. Ekuivalenti i monedhës kombëtare mund të mbahet i pandryshuar në rast se konvertimi do të rezultonte në një pakësim në atë vlerë ekuivalenti.

5. Sasitë e shprehura në euro duhet të rishikohen nga Komiteti i Përbashkët me kërkesë të Republikës së Maqedonisë ose Republikës së Shqipërisë. Kur të kryejë këtë rishikim, Komiteti i Përbashkët duhet të konsiderojë dëshirën e palëve për të ruajtur pasojat e efekteve të limiteve në terma reale. Për këtë qëllim, ai mund të vendosë për të modifikuar shumat e shprehura në euro.

KREU VI

RREGULLIME PËR BASHKËPUNIMIN ADMINISTRATIV

Neni 31

Asistenca reciproke

1. Autoritetet doganore të Republikës së Maqedonisë ose Republikës së Shqipërisë duhet t'i sigurojnë njëra-tjetrës kopje të llojit të vulave, të përdorura në zyrat e tyre doganore për lëshimin e certifikatave të lëvizjes EUR.1 dhe adresat e autoriteteve përgjegjëse doganore për verifikimin e këtyre certifikatave dhe deklaratave faturore.

2. Me qëllim që të sigurohet aplikimi i duhur i këtij Protokoli, Republika e Maqedonisë ose Republika e Shqipërisë duhet të ndihmojnë njëra-tjetrën nëpërmjet administratave doganore kompetente në kontrollin e autenticitetit (origjinalitetit) të certifikatave të lëvizjes EUR.1 ose të faturave të deklarimit, si dhe korrektësinë e informacionit të dhënë në këto dokumente.

Neni 32

Verifikimi i provave të origjinës

1. Verifikimet e duhura të provave të origjinës duhet të kryhen me metodën e zgjedhjes së rastit ose, sa herë që autoritetet doganore të vendit importues kanë dyshime të arsyeshme për autenticitetin e dokumenteve të tillë, për statusin e origjinës së produkteve përkatëse ose për përmbushjen e kërkesave të tjera të këtij Protokoli.

2. Për qëllimet e zbatimit të dispozitave të paragrafit 1, autoritetet doganore të vendit importues duhet t'ia kthejnë certifikatën e lëvizjes EUR.1, si dhe faturën, në rast se është paraqitur, ose një kopje të këtyre dokumenteve, autoriteteve doganore të vendit eksportues, duke u dhënë, atëherë kur është e nevojshme, arsyet për hetimin. Çdo dokument dhe informacion i marrë, i cili thotë se informacioni i dhënë mbi provën e origjinës është jo korrekt, duhet të jepet në mbështetje të kërkesës për verifikim.

3. Verifikimi duhet të kryhet nga autoritetet doganore të vendit eksportues. Për këtë qëllim,

ato duhet të kenë të drejtën të thërrasin për çdo dokument dhe të kryejnë çdo inspektim të llogarive të eksportuesit ose çdo lloj kontrolli që konsiderohet i përshtatshëm.

4. Në rast se autoritetet e vendit importues vendosin të pezullojnë dhënien e trajtimit preferencial për produktet respektive, ndërsa presin rezultatet e verifikimit, produktet duhet t'i ofrohen importuesit, me qëllim të marrjes së ndonjë mase kujdesi të gjykuar të nevojshëm.

5. Autoritetet doganore që kërkojnë verifikimin duhet të informohen për rezultatet e këtij verifikimi sa më shpejt që të jetë e mundur. Këto rezultate duhet të tregojnë qartë se dokumentet janë origjinale dhe nëse produktet përkatëse mund të konsiderohen si produkte që janë me origjinë nga Republika e Maqedonisë ose Republika e Shqipërisë dhe të plotësojnë kërkesat e tjera të këtij Protokollit.

6. Në rastet e dyshimit të arsyeshëm dhe kur nuk ka përgjigje brenda 10 muajve nga data e kërkesës së verifikimit ose në rast se përgjigja nuk përmban informacion të mjaftueshëm për të përcaktuar autenticitetin e dokumentit në fjalë ose origjinën e vërtetë të produkteve, autoritetet doganore kërkuese të hetimit duhet, me përjashtim të rrethanave të jashtëzakonshme, të refuzojnë dhënien e preferencave.

Neni 33

Zgjidhja e mosmarrëveshjeve

Kur ka mosmarrëveshje lidhur me verifikimin e procedurave të nenit 32, të cilat nuk mund të zgjidhen mes autoriteteve doganore që kërkojnë një verifikim dhe autoriteteve doganore përgjegjëse për kryerjen e këtij verifikimi, ose kur ato ngejnë një pyetje lidhur me interpretimin e këtij Protokollit, ato duhet t'i paraqiten Komitetit të Përbashkët.

Në të gjitha rastet, zgjidhjet e mosmarrëveshjeve ndërmjet importuesit dhe autoriteteve doganore të vendit importues duhet të respektojnë legjislacionin e vendit importues.

Neni 34

Gjobat

Gjobat duhet të vendosen mbi çdo person që fsheh ose shkakton fshehjen të një dokumenti që përmban informacion jokukshtet për qëllimin e marrjes së trajtimit preferencial për produktet.

Neni 35

Zonat e lira

1. Republika e Maqedonisë dhe Republika e Shqipërisë do të marrin të gjitha masat e nevojshme për të siguruar që produktet e tregtuara nën mbulimin e një prove origjine, e cila qëndron gjatë transportit dhe që përdorin një zonë të lirë që është në territorin e tyre, të mos zëvendësohen nga mallra të tjera dhe të mos pësojnë përpunim tjetër veç veprimeve normale që parandalojnë përkeqësimin e gjendjes së mallrave.

2. Me anë të një përjashtimi të dispozitave të përmbajtura në paragrafin 1, kur produktet me origjinë nga Republika e Maqedonisë ose Republika e Shqipërisë importohen në një zonë të lirë nën mbulimin e një prove në origjinë dhe pësojnë trajtim ose përpunim, autoritetet përkatëse duhet të lëshojnë një certifikatë të re EUR.1 me kërkesë të eksportuesit, në rast se trajtimi dhe përpunimi i pësuar është në përputhje me dispozitat e këtij Protokollit.

KREU VII

DISPOZITAT PËRFUNDIMTARE

Neni 36

Nënkomiteti mbi Doganat dhe Çështjet e Origjinës

Një nënkomiteti mbi doganat dhe çështjet e origjinës duhet të ngrihet nënkomitetin e Përbashkët për ta ndihmuar atë në kryerjen e detyrave të tij dhe për të siguruar një informacion të vazhdueshëm dhe konsultim të përpunuar mes ekspertëve. Ai duhet të përbëhet nga ekspertë prej të

dyja Palëve përgjegjëse për çështjet që lidhen me doganat dhe problemet e origjinës.

Neni 37

Amendamente ndaj Protokollit

Komiteti i Përbashkët mund të vendosë të amendojë dispozitat e këtij Protokollit.

ANEKSI I

SHËNIME PREZANTUESE TË LISTËS NË ANEKSIN II

Shënim 1:

Lista paraqet kushtet e kërkuara për të gjitha produktet për t'u konsideruar si të punuara ose të përpunuara mjaftueshëm brenda kuptimit të nenit 6.

Shënim 2:

2.1. Dy kolonat e para në listë përshkruajnë produktin e marrë. Kolona e parë jep numrin kryesor ose numrin e kreut, të përdorur në Sistemin e Harmonizuar dhe kolona e dytë jep përshkrimin e mallrave të përdorura në atë sistem për atë krye apo kapitull. Për secilën hyrje, në dy kolonat e para një rregull specifikohet në kolonën 3 ose 4. Ndërsa, në disa raste, hyrja në kolonën e parë paraqitet nga një “ish”, që nënkupton se rregullat në kolonën 3 ose 4 aplikohen vetëm për pjesën e atij kreut, sikurse është përshkruar në kolonën 2.

2.2. Atëherë kur shumë numra krerësh grupohen së bashku në kolonën 1 ose një numër kapitulli jepet dhe përshkrimi i produkteve në kolonën 2, prej këtej jepen, në terma të përgjithshme, rregullat e afërt, në kolonën 3 dhe 4 aplikohen për të gjitha produktet, të cilat, nën Sistemin e Harmonizuar klasifikohen në kryet e kapitullit ose në secilën nga krerët e grupuara së bashku në kolonën 1.

8201	Veglat e punës së dorës, të mëposhtmet; lopata, bel, shat, kazma, rrashqel, sfurqet e krehëra; akset, grep me sqepa e vegla të ngjashme prerëse; gërshërë krasitëse të çdo lloji; kosa, drapër, thika bari, gërshërë për krasitje gardhi, pyka druri e vegla të tjera të një lloji të përdorur në agrikulturë , kopshtari apo në pylltari.
8202	Sharra dore; tehet për sharrat të të gjitha llojeve (përfshirë tehet për frazë diskore, për sharra për gdhendje apo për sharra pa dhëmbëza).
8203	Limat, raspe, dara (përfshirë darat prerëse), pinca, pinceta, gërshërë për prerjen e metaleve, prerës tubash, prerës bullonash, shpuesit apo biruesit dhe vegla të ngjashme dore.
8204	Çelës dadosh e çelësa anglez të operuar me dorë (përfshirë çelësat përdredhëmatës por nuk përfshin metravidat); çelës ballor i ndërrueshëm, me ose pa doreza.
8205	Vegla dore (përfshirë diamantet për prerjen e qelqit), të papërfshira e të paspecifikuara diku tjetër; llampë me fryrje zjarri; morsa, fasheta e artikujt të ngjashëm shtrëngues, përveçse plotësuesit e pjesët për e pjesët e, veglave makine; kudhëzat; furrat portative; rrotat grirëse të operuara me dorë apo me pedale me gjithë skeletin e tyre.
8206 00 00 00	Veglat e dy apo më shumë krerëve nr.8202 deri 8205, vendosur në një grup për shitjen me pakicë.
8207	Vegla të ndërrueshme për veglat e dorës, nëse janë apo jo të operueshme me fuqi, apo për vegla makine (psh, për shtypje, stampim, prerje, filetim, birim, shpim, shpim me presion, bluarje, thërmim apo shtrëngim vidash), përfshirë matricat për nxjerrjen e derdhjeve metalike apo stampim në të nxehtë të metaleve, e veglat për birime në shkëmb apo për shpime në tokë.
8211	Thikat me tehun prerës, në formë sharre apo jo (përfshirë hikat për krasitje), përveçse thikave të kreut nr.8208, e tehet e tyre.
8215	Lugët, pirunët, garuzhde, biralie, shërbyese keku, thika peshku, thika gjalpi, kapëse sheqeri e pajisje të ngjashme për tavolinë apo për kuzhinë.
8301	Drynet e kyçet (çelësat, të operuar elektrikisht apo në mënyrë të kombinuar), prej metali bazë; grepat e skeletet me grepa, të trupëzuar me kyçet, prej metaleve bazë; çelësat përçdo nga artikujt e sipërpërmendur, prej metali bazë.
8302	Mbajtëset, pajisje prej metaleve bazë e artikujt të ngjashëm të përshtatshme për t'u përdorur me mobileritë, dyert, shkallët, dritaret, grila dritaresh, karrocëritë, pajisjeve të kalit, bauleve, sënduqeve, kutive apo për artikujt të ngjashëm: mbajtëse e varesë kapelesh e fiksues të tjerë të ngjashëm prej metali bazë; rrotëza apo rule për mobileritë me mbajtëse për to prej metaleve bazë; mbyllësit automatikë të dyerve prej metali bazë.

8304 00 00 00	Dollape për dosje, dollape për indeksat e dokumenteve, tabaka për vendosjen e letrave, mbajtëse letrash, mbajtëse lapsash, mbajtëse të kancelarive të zyrës e pajisje të ngjashme tavoline apo zyre, prej metali bazë, përveç mobilerive të zyrës të kreut nr.9403.
8309	Mbyllësa, tapa e kapaqe (përfshirë tapat në formë kurore, kapakët në formë vide e tapat me mjete derdhjeje), kapsulat për shishe, tapa të filetuara, mbuluesit e tapave, vulat e plotësues të tjerë pakëtues, prej metali bazë.
8460	Veglat-makinë, për kthimin e buzëve, mprehjen, zmerilimin, honingimin, lidhje me mbivënie, llustrosjen apo për përfundimin ndryshe të metaleve apo të metaloqeramikave me anë të gurëve zmerile, produkteve abrazive apo llustrosës, të ndryshme nga makinat me igranazhe prerëse, igranazhe zmerilizimi apo igranazhe përfunduese të kreut nr.8461.
8463	Vegla-makinë të tjera për punimin e metaleve apo etaloqeramikave, pa zhvendosjen e materialit.
8464	Veglat-makinë për punim e gurëve, qeramikave, betoneve, asbestocementeve ose materialeve të ngjashme minerale apo për përpunimin në të ftohtë të qelqit
8480	Kutitë kallëpe për fonderinë e metaleve; bazat e kallëpeve; mostrat e kallëpeve; kallëpet për metalet (të ndryshme nga kallëpet për shkrimje metali), karbiteve, qelqit, materialeve minerale, për gomat ose plastikat.
8525	Aparate marrëse për televizion, nëse janë apo jo të bashkangjitur me marrësa radio apo aparate rregjistrimi apo riprodhimi video apo të tingullit; monitorët video e video projektorët.
9404	Mbështetëset e mbajtëset e dyshekëve; artikujt e krevatëve e të ngjashmet (p.sh dysheqet, jorganet me pambuk apo me pupla, jastëqet e fjetjes, pufetë e jastëqet e zbukurimit), të pajisura me susta apo të mbushura apo përshtatur nga brenda me çdo material apo prej gome celulare apo plastike, nëse janë apo jo të mbuluara.
9405	Llampat e pajisje ndriçuese përfshirë projektorët e ndriçuesit projektorë e pjesët e tyre, të papërfshirë e të paspecifikuar diku tjetër; shenjat ndriçuese, pllakat e emrit ndriçuese e të ngjashmet e tyre, të cilët kanë një burim drite të fiksuar të përhershëm, e pjesët e tyre të papërfshira e të paspecifikuara diku tjetër.
9601	Fildish, kocka, guacka breshkash, brirë, brirët e drerëve meshkuj, korale, mëma perlash e materiale të tjera të gdhendshme me origjinë kafshore, të punuara e artikujt e këtyre materialeve (përfshirë artikujt e fituar nga kallëpimi).
9602 00 00 00	Materiale vegjetale të punuara apo materiale minerale të gdhendshme, e artikujt e këtyre materialeve; artikujt e gdhendur apo të kallëpuar prej dylli, stearinë, prej gome natyrale apo rezin natyral apo prej pastave modeliste, e artikujt të tjerë të kallëpuar apo të gdhendur, të papërfshira apo specifikuar diku tjetër; xhelatinë e pa forcuar, e punuar (përveç xhelatinës së kreut nr.35.03) e artikujt prej xhelatine të pa forcuar.
9603	Fshesat, furçat (përfshirë furçat që përbëjnë pjesë të makinerive, pajisjeve apo mjeteve lëvizëse); fshirësit e dyshemesë mekanike të operuara me dorë, të pa motorizuara, fshirësit e pluhurave me pendë e ato me fitila; xhufkat e nyjet e përgatitura për bërjen e fshesave apo furçave; mbushjet e roletë thithëse të bojrave; fshirëset e ujit (përveç atyre në fomë roleje).
9604 00 00 00	Sitat e dorës dhe shoshat e dorës.
9605 00 00 00	Grup mallrash për udhëtime, të përdorura për tualet personal, për qepje apo për pastrimin e këpucëve ose të rrobave.
9606	Butonat, mbërthyesit me shtypje, sustat e komçat, format e butonave e pjesët e tjera të këtyre artikujve; vrimat e butonave.
9607	Mbërthyesit e rrëshqitshëm e pjesët e tyre.
9608	Penat me majë të rrumbullakët; penat e shënuesit me majë të mbushur e të tjerë me majë poroze; stillogragat, penat-stillograf e pena të tjera; lapsat kopjative; lapsat rrëshqitës; mbajtësit e lapsave e stilolapsave e mbajtës të ngjashëm; pjesët (përfshirë kapakët e kapësit) e artikujve të sipërpërkshkruar, përveç atyre të kreut nr.9609.
9609	Lapsat (përveç lapsave të kreut nr.9608), lapsat me ngjyrë, mbushjet prej plumbi të lapsave, pastelet, qymyri i drurit për vizatime, shkumësat e shkrimit apo vizatimet e shkumësat e rrobaqepësve.
9610 00 00 00	Pllakat e dërrasat e shkrimit, me sipërfaqe shkrimi apo vizatimi, nëse kanë apo jo kornizë.
9611 00 00 00	Stampat e datave, vulave apo numërimeve, e të ngjashmet e tyre (përfshirë mjetet për shtypjen apo prerjen e etiketave), destinuar për tu operuar me dorë; shirita radhitës të operuara me dorë e grupe mallrash të shtypjes me dorë të trupëzuar me shirita të tilla radhitës.
9612	Shiritat për makinat e shkrimit apo shirita të ngjashëm, të bojatisur apo të përgatitur ndryshe për dhënie e impresioneve, nëse janë apo jo në rotka apo në bobina; tamponet e bojës, nëse janë apo jo me bojë, me apo pa kuti
9613	Çakmakët e cigareve e ndezësit e tjerë, nëse janë apo jo mekanike apo elektrike e pjesët e tyre të ndryshme nga stralli e fitili.
9614	Çibuqet (përfshirë llullat) e mbajtësit e duhanit apo të cigareve e pjesët e tyre.
9615	Krehërat, furçat e flokëve e të ngjashmet e tyre; kapëse flokësh, kapëset e kacurrelave, bigutinat e të ngjashmet e tyre, përveç atyre të kreut nr.8516, e pjesët e tyre.
9616	Sprucot e parfumeve e sprucot e ngjashme të tualetit, e mbajtëset e kokat e tyre; pufetë e pudrave e mbushjet për aplikimin e preparateve të kozmetikës apo të tualetit.
9617 00	Enët laboratorike apo mjete të tjera vakum, të kompletuar me kutitë; pjesët e tyre përveç të brendshmet prej qelqi
9618 00 00 00	Manakinët e rrobaqepësve e figura të tjera të ngjashme; automatet e shfaqes të tjerë të lëvizshëm

përdorur për vitrinat e dyqaneve të rrobave

2. Tarifat doganore, të aplikuara në Republikën e Maqedonisë, për produktet me origjinë nga Republika e Shqipërisë, sipas kësaj liste, do të reduktohen në përputhje me kohëzgjatjen e mëposhtëme

Viti i parë në 80% të tarifës bazë

Viti i dytë në 65% të tarifës bazë

Viti i tretë në 50% të tarifës bazë

Viti i katërt në 35% të tarifës bazë

Viti i pestë në 20% të tarifës bazë

Viti i gjashtë në zero

Kodi tarifier	Përshkrimi
2515	Mermer, tuf gëlqeror, ekauzinë e gurë të tjerë monumentale apo ndërtimore gëlqerore të një graviteti të jashtëm specifik prej 2.5 apo më shumë, e alabastër, nëse është apo jo e punuar trashë apo thjesht e prerë, nga sharrimi apo ndryshe, në blloqe apo pllaka në formë drejtkëndëshe (përfshirë katrorin).
2520	Gips, anhidrit; suva (e përbërë nga gipsi i kalcinuar apo sulfat kalciumi) nëse është apo jo e ngjyrosur, me ose pa sasi të vogla të përshpejtuesve apo të ngadalsuesve.
2523	Çimento portland, çimento oksidalumini, çimento skorjesh, çimento supersulfati e çimento të ngjashme hidraulike, nëse janë apo jo të ngjyrosur apo në formën e klinkerit.
2524 00	Asbesti.
2710 00	Vajrat e naftës e vajra të fituara prej mineraleve bituminoze, ndryshe nga bruto; preparate të paspecifikuara e të papërfshira diku tjetër, që përmbajnë ndaj peshës 70% apo më shumë vajra naftë apo vajra të fituara nga mineralet bituminoze, këto vajra duhet të jenë përbërësit bazë të preparatit
2711	Gazet e naftës dhe hidrokarbure të tjera gazoike.
3208	Bojra e llustruesit (përfshirë smaltat e llaqet) bazuar në polimere sintetike apo polimere natyrale kimikisht të modifikuara, të shpërndara apo të tretura në një mjedis jo ujor; solucionet e përcaktuara në shënimin 4 të këtij kapitulli.
3209	Bojrat e llustruesit (përfshirë smaltat e llaqet) bazuar në polimerët sintetike apo në polimerët natyralë të modifikuara kimikisht, të shpërndara apo të tretur në një mjedis ujor.
3214	Stuko xhami, stuko shartuese, cimente resini, përbërjet montuese e mastice të tjera; mbushjet e piktorëve; preparatet jo refraktare sipërfaqësore për fasada, mure të brendshme, dysheme, tavane të brendshme apo të ngjashmet e tyre.
3904	Polimere të vinilkloridit apo të olefinave të tjera të halogjenizuara, në forma primare.
3905	Polimere të vinil acetatit apo të esterëve të tjerë vinil, në forma primare; polimere të tjerë vinil në forma primare.
3915	Mbetjet, prerjet e kthimet, prej plastike.
3917	Tuba, pipa e zorra dhe përshtatjet e tyre (psh, brylat, bashkimet, flanxhat), prej plastike
3918	Mbuluesit e dyshemesë prej plastike, nëse janë apo jo vetë ngjitëse, në role apo në formën e pllakave; mbuluesit e mureve apo tavanëve prej plastike, siç janë të përcaktuara në shënimin 9 të këtij kapitulli.
3919	Pllaka, fleta, filma, krisafe, shirita e forma të tjera të rregullta, vetëngjitëse, prej plastike, nëse janë apo jo në role.
3920	Pllaka, fleta, filma, krisafe e shirita të tjerë, prej plastike, jo celulare e jo të përforcuara, jo të laminuara të pambështetura apo të pakombinuara në mënyra të ngjashme me materiale të tjera.
3921	Pllaka, fleta, filma, krisafe e shirita të tjera, prej plastike.
3923	Artikujt për mbajtjen apo paketimin e mallrave prej plastike; tapat, kapaqet, kupat e mbyllës të tjerë, prej plastike.
3924	Pajisjet e tavolinës, të kuzhinës, artikujt të tjerë shtëpiakë e artikujt të tualetit, prej plastike.
3925	Pajisjet e ndërtimit prej plastike, të papërfshira e të paspecifikuara diku tjetër.
3926	Artikujt të tjerë prej plastike e artikujt prej materialeve të tjera të krerëve nr.3901 deri 3914.

4012	Goma rrote të përdorura apo të riveshura pneumatike prej gome; goma rrote të forta apo të mbushura, veshje të ndërrueshme të rrotave prej gome e mbyllësit e tyre prej gome.
4013	Tuba të brendëshme, prej gome.
4201 00 00 00	Takëme e pajimet për çdo lloj kafshe (përfshirë rripat për tërheqje, rripat e qenëve, gjynjakët, shalë kali, samarët, patkonjtë, mbulesat e qenve dhe të ngjashmet e tyre) prej çdo lloj materiali.
4302	Gëzofët e rregjur apo të punuar në sipërfaqe (përfshirë kokat, bishtat, putrat e pjesë apo prerje të tjera), të pabashkuara, apo të bashkuara (pa shtesën e materialeve të tjera) përveç atyre të kreut nr.4303.
4303	Artikuj të veshjes, të rrobave plotësuese e artikuj të tjerë prej gëzofi.
4304 00	Gëzof artificial e artikuj prej tyre.
4409	Dru (përfshirë shiritat e pllakat për dyshme parketi, jo të bashkuara), të profiluar (bashkuar me gjuhëz apo me pllaka, në formë ulluqesh, në formë shiritash, me fole apo me buzë, të zgavruara, bashkuar në formë V, në formë rruazash, të rrumbullakosura apo në forma të ngjashme) përgjatë çdo nga anët apo faqet e tij. Nëse janë apo jo të zdrukthtuara të polimeruara me ashpam apo të gjitur nga kllapat bashkuese.
4415	Kutitë paketuese, arka, sënduqe, tambure e paketues të ngjashëm prej druri: tambure prej druri për kablo; paletet, kutitë e paletave e panele të tjera për ngarkim prej druri; mbështjellëset e paletave prej druri.
4418	Artikuj të zdrukthtarisë e pjesët e armaturave prej druri të përdorura në ndërtim, përfshirë panelet qelizore të drurit, panele parketi të bashkuara, petavrat e çative.
4802	Letër e karton i paveshur, të një lloji të përdorur për shkrime, shtypje, apo për qëllime të tjera grafike, e letra për skeda e për shiritat të përforuar, e role apo në fleta, përveçse letrës së kreut nr.4801 apo 4803; letra e kartoni të bëra me dorë.
4805	Letër e karton tjetër i paveshur, në role apo në fleta, jo më tej të punuara apo të procesuara sesa siç është specifikuar në SHënimin 2 të këtij kapitulli.
4808	Letër e karton, të valëzuara (me ose pa fleta të holla ngjitëse në sipërfaqe) me krep, me plisë, të stampuara apo të përforuara, në role apo në fleta, përveç letrës së llojit të përshkruar në kreun nr.4803.
4819	Kartonet, kutitë, valixhet, çantat e konteniere paketues të ngjashëm, prej letre, kartoni, mbushjeve celulozike apo tekstileve prej fibrave celulozikë; dosje, mbajtëse letrash e artikuj të ngjashëm, prej letre ose kartoni të një lloji të përdorur në zyra, dyqane apo në vende të ngjashme.
5109	Fije leshi apo prej qimeve të holla të kafshëve, të vendosur për shitjen me pakicë.
5110 00 00 00	Fije prej qimeve të ashpra të kafshëve apo prej flokëve të kalit (përfshirë flokë kali të bëra në formë spirale), nëse janë apo jo të vendosura për shitjen me pakicë.
5701	Qylymat e mbulues të tjerë tekstilë të dyshemesë, me nyje, nëse janë apo jo të ndërtuara.
5702	Qylymat e mbulues të tjerë tekstilë të dyshemesë, të endura jo me xhufka apo me flokë, nëse janë apo jo të ndërtuara, përfshirë te qylymat e quajtura "Kelem". "Schumacks", "Karamanie" e rrugica të ngjashme të endur me dorë.
5703	Qylyma e mbulues të tjerë tekstilë të dyshemesë, me xhufka, nëse janë apo jo të ndërtuara.
5704	Qylymat e mbuluesit e tjerë tekstilë të dyshemesë, prej shajaku, jo me xhufka apo me flokë, nëse janë apo jo të ndërtuara.
5705 00	Qylyma të tjerë e mbulues të tjerë tekstili të dyshemesë, nëse janë apo jo të ndërtuara.
5801	Pëlhura të endura me fije të dala sipër e pëlhurat me push të krehur, përveç pëlhurave të kreut nr.5802 apo 5806.
5802	Artikuj të përdorur për fshirje të llojit si peshqir e pëlhura të ngjashme të endura si peshqir, përveç pëlhurave të ngushta të kreut nr.5806; pëlhura tekstile me xhufka, përveç produkteve të kreut nr.5703.
5803	Garza, përveçse pëlhurave të ngushta të kreut nr.5806.
5804	Tylet e pëlhura të tjera në formë rrjete, pa përfshirë pëlhurat e endura, pëlhurat e thurura me një fije apo me shumë fije; tantellat në copa, në shiritat apo në motive, ndryshe nga pëlhurat e kreut Nr.6002.
5805 00 00 00	Tapiceritë e endura me dorë të llojit Gobelins, Flanders, Aubusson, Beauvais e të ngjashmet e tyre, tepiceritë e punuara me gjilpërë (psh me pika të vogla apo me syth kryq), nëse janë apo jo të ndërtuara.
5806	Pëlhura të ngushta të endura, përveç mallrave të kreut nr.5807; pëlhura të ngushta të përbëra nga baza pa indin të bashkuara nëpërmjet një ngjitësi (bolducs).
5807	Etiketat, simbolet e artikuj të ngjashëm prej materiali tekstili, në copa në shiritat, apo të prera në forma apo në masa, të paqendisura.
5808	Gajtanet në copa; zfukurimet ornamentale në copa, pa qëndisma, ndryshe nga të thurura me një fije apo me shumë fije; xhufkat, tufëzat e artikuj të ngjashëm.
5809 00 00 00	Pëlhura të endura prej fijeve metalike e pëlhura të endura prej fijeve të metalizuara të kreut nr.6505, të një lloji të përdorur në artikujt e veshjes, për mobileritë apo për qëllime të ngjashme, të paspecifikuara e të papërfshira diku tjetër.
5810	Qëndismat në copa, në shiritat apo në motive.
5811 00 00 00	Produktet tekstile të mbushura në copa, të përbëra nga një apo më shumë shtresa prej materiali tekstili bashkuar me mbushjen nëpërmjet qepjes apo ndryshe, përveç qëndismave të kreut nr.5810.
6001	Pëlhura me push e përfshirë pëlhurat "me push të gjatë" e pëlhurat me bukule në formë peshqiri, të

	thurura me shumë fije apo me një fije.
6002	Pëlhura të thurura me një fije apo me shumë fije, me një gjerësi që nuk kalon 30 cm, që përmban 5% ose më shumë ndaj peshës fill elastomerik ose fill kaucuku, të ndryshme nga ato të kreut nr..6001
6003	Pëlhura të thurura me një fije apo me shumë fije, me një gjerësi që nuk kalon 30 cm, të ndryshme nga ato të krerëve nr. ose 6002
6004	Pëlhura të thurura me një fije apo me shumë fije, me një gjerësi që kalon 30 cm, që përmban 5% ose më shumë ndaj peshës fill elastomerik ose fill kaucuku, të ndryshme nga ato të kreut nr. 6001.
6005	Pëlhura të përkulura dhe thurura (përfshirë ato të bëra në gallonat e makinerive të (thurjesh), të ndryshme nga ato të krerëve nr..6001 deri 6004.
6006	Pëlhura të tjera, të thurura me një apo shumë fije.
6102	Pallto të mëdha, pallto për makina, pelerinat, mantelet, anorakset (përfshirë xhaketat për ski), xhupa të lehtë, xhaketa kundër erës e artikuj të ngjashëm për djem e burra, të thurura me një fije apo me shumë fije, përveç atyre të kreut nr.61.03
6103	Kostume, ensemble, xhaketa të lehta, pantallona, kominoshe me gjoksore e me tiranta, pantallona me këmbë të shkurtra e pantallona të shkurtra (përveç rrobave të banjës), për djem e burra, të thurrua me një fije apo me shumë fije.
6104	Kostume, ensemble, xhaketa, fustane, fund pantallona, pantallona, kominoshe me gjoksore e tiranta, pantallona të shkurtra deri në gju e pantallona më të shkurtra (përveç rrobave të banjës), për vajza e gra, të thurura me një fije apo me shumë fije.
6105	Këmisha burrash e djemsh, të thurura me një fije apo me shumë fije.
6106	Bluza, këmisha dhe këmisha bluza për gra e vajza, të thurura me një fije apo me shumë fije
6107	Mbathje, të brendshme, bluza nate, pizhame, rroba dushi, rrobdishamber e artikuj të ngjashëm për burra e djem, të thurura me një fije apo me shumë fije.
6108	Kombinezone, këmisha të brendshme, mbathje të brendshme, veshje nate, pizhama, rrobdishamber, rroba dushi, rroba të lehta për të ndenjur në shtëpi e artikuj të ngjashëm për vajza e gra, të thurura me një fije apo me shumë fije T-shirts, fanella pa mëngë e kanatjere të tjera, të thurura me një fije apo me shumë fije.
6109	T-shirts, fanella pa mëngë e kanatjere të tjera, të thurura me një fije apo me shumë fije
6110	Fanella me mëngë të gjata., pulovra, triko, jeleqe e artikuj të ngjashëm, të thurura me një fije apo me shumë fije.
6111	Veshje bebesh e plotësues të veshjeve të bebeve, të thurura me një fije apo me shumë fije
6112	Veshje të sipërme për sport, veshje për ski e not, të thurura me një fije apo me shumë fije
6113 00	Veshje, të ndërtuara prej pëlhurave të thurura me një fije apo shumë fije të kreut nr.5903, 5906 apo 5907.
6114	Veshje të tjera, të thurura me një fije apo me shumë fije.
6115	Geta, çorape të shkurta, çorape të gjata e lloje të tjera çorapesh , përfshirë çorapet për variçet e veshjet e këmbëve pa shputën, të thurura me një fije apo me shumë fije.
6116	Dorezat, dorezat me një gisht e dorezat pa gishta, të thurura me një ile apo me shumë fije.
6117	Plotësues të tjerë të ndërtuar të veshjeve, të thurura me një fije apo me shumë fije' pjesë të veshjeve apo të plotësuesve të tyre të thurura me një fije apo me shumë file.
6201	Pallto të mëdha, pallto për makina, pelerina, mantele, anorakse (përfshirë xhaketat për ski), xhupa të lehta, xhaketa kundër erës e artikuj të ngjashëm, për djem dhe burra, përveç atyre të kreut nr.6203.
6202	Pallto të mëdha, pallto për makina, pelerina, mantele, anorakse (përfshirë xhaketat për ski) xhupa të lehta, xhaketa kundër erës e artikuj të ngjashëm, për gra dhe vajza, përveçse atyre të kreut nr.6204.
6203	Kostume, ensemble, xhaketa të lehta, pantallona, kominoshe me gjoksore e tiranta, pantallona të shkurtra deri në gju e pantallona me të shkurtra (përveçse rrobave të banjës), për djem e burra.
6204	Kostume, ensemble, xhaketa, fustane, funde, fund pantallona, pantallona, kominoshe me gjoksore e tiranta. Pantallona me këmbë të shkurtra e pantallona të shkurtra (përveç rrobave të banjës), për vajza e gra.
6305	Këmisha burrash e djemsh.
6206	Bluza, këmisha e këmisha-bluza për gra e vajza.
6207	Kanatjere e fanella të tjera, mbathje të brendshme, bluza nate, pizhama, rroba dushi, rrobdishamble e arikuj të ngjashëm, për burra e djem.
6208	Kanatjere e fanella të tjera, kombinezone, këmisha të brendshme, mbathje të brendshme, veshje nate, pizhama, rrobdishamble, rroba dushi, rroba të lehta për të ndenjur në shtëpi e artikuj të ngjashëm, për vajza e gra.
6209	Veshje bebesh dhe plotësues të veshjeve të bebeve.
6210	Veshje të ndërtuara prej pëlhurave të kreut nr.5602, 5603,5903,5906 apo 5907
6211	Veshje të garave, kostume skije e veshje për not; veshje të tjera
6212	Mbajtëse gjoksi, tiranta, korse, rripa, varëse mbajtëset e çorapeve e artikuj të ngjashëm e pjesët e tyre, nëse janë apo jo të thurura me një fije apo me shumë fije.
6213	Shamitë.
6214	Shall për qafe, për koke apo suipë, shallet e qendisur, perçet dhe artikuj të ngjashëm.

6215	Jakat, kravatat dhe papionët.
6216 00 00 00	Dorezat, dorezat me një gisht dhe dorezat pa gishta.
6217	Plotësues të tjerë të ndërtuar të veshjeve; pjesë të veshjeve apo plotësuesve të veshjeve, ndryshe nga ato të kreut nr.6212.
6301	Batanijet e zakonshme e batanijet e trasha për udhëtim.
6302	Shtresa krevati, shtresa tavoline, shtresa tualeti e shtresa kuzhine.
6303	Perdet (përfshirë perdet e dritareve) e grilat e brendshme; perdet për krevate. -Të thurura me një fije, apo me shumë fije.
6304	Artikuj të tjerë mobilues, përjashto ato të kreut nr.9404. -Mbulesat e krevatit.
6305	Thasët e çantat, të një lloji të përdorur për paketimin e mallrave.
6306	Pëlhurë rezistente ndaj ujit trajtuar me katran, tenda mbrojtëse ndaj shiut e tenda dielli; tenda; velat për anijet apo për varkat me vela; mallra kampingu -Pëlhura rezistente ndaj ujit trajtuar me katran, tenda mbrojtëse ndaj shiut e tenda dielli.
6307	Artikuj të tjerë të ndërtuar, përfshirë pjesë të veshjeve.
6308 00 00 00	Grupet e përbëra nga pëlhurë e endur e fije, nëse janë apo jo plotësues, për t'u ndërtuar, në rrugica, tapisteri, mbulesa zbkurimi tavoline apo në peceta tavoline të qëndisura, apo në artikuj të ngjashëm tekstile, vendosur në paketa për shitjen me pakicë.
6401	Veshjet e këmbëve të qëndrueshme ndaj ujit me suprinat e shuallin e jashtëm prej gome apo prej plastike, suprinat e të cilave nuk janë as të fiksuara me shuallin as të bashkuara nga ngjitja, me anë të perçinave, nga gozhdimi, vidhosja, ngjeshja apo prej proceseve të ngjashme.
6402	Veshje të tjera këmbë me suprinën e shuallin e jashtëm prej gome apo plastike.
6403	Veshje të këmbëve me shuallin e jashtëm prej gome, plastike, lëkurë të ripunuar e suprinën prej lëkure.
6404	Veshjet e këmbëve me shuallin e jashtëm prej gome, plastike, lëkurë apo lëkurë të ripunuar e suprinën prej materiali tekstili.
6405	Veshje të tjera këmbë.
6406	Pjesët e veshjeve të këmbëve (përfshirë suprinën nëse është apo jo e ngjitur tek shualli përveçse shuallit të jashtëm); shualli i brendshëm i lëvizshëm, mbushje të takave e artikuj të ngjashëm; gjynjakët, mbajtëse kërcinjsh e artikuj të ngjashëm e pjesët e tyre.
6802	Gurët e punuar monumentale apo të ndërtimeve (përveç eternitit) e artikujt prej tyre, përveç mallrave të kreut nr.6801; kubet mozaike e të ngjashmet e tyre, prej guri natyral (përfshirë eternitin), nëse janë apo jo me bazament; granulë, feta të holla dhe pluhur, të ngjyrosur artificialisht, prej guri natyral (përfshirë eternitin).
6807	Artikujt prej asfaltit apo prej materialeve të ngjashme (për shembull, bitum naftë apo katran qymyri).
6808 00 00 00	Panelet, shtresat, pllakat, bllloqet e artikuj të ngjashëm prej fibrave vegjetale, prej kashte apo prej copave, ashklave pluhurit, ciflave apo mbetjeve të tjera, të drurit, të aglomeruar me çimento, allçi apo me lidhës të tjerë minerale.
6809	Artikuj prej allçie apo prej përbërjeve me bazë allçie.
6810	Artikuj prej çimentos, prej betonit apo prej gurëve artificiale, nëse janë apo jo të përforcuar.
6811	Artikujt prej asbesto-çimentos fibroze celulozike apo prej të ngjashmëve të tyre.
6812	Fibra të fabrikuara të asbestit: përzierjet me një bazë të asbestit apo me një bazë të asbestit e të karbonatit të magnezit; artikuj të përzierjeve të tilla apo të asbestit (p.sh. fill, pëlhurë e endur, veshje, veshje koke, veshje këmbë, mbushje asbesti), nëse janë apo jo të përforcuara, përveç mallrave të kreut nr.6811 apo 6813.
6813	Materiale fërkuese e artikujt prej tyre (p.sh. fleta, role, shirita, segmente, disqe, rondele, mbushës), jo me formë, për frena, për dhëmbët e rrotave apo për të ngjashmet e tyre, me një bazë të asbestit, të substancave të tjera minerale apo të celulozës, nëse janë apo jo të kombinuara me tekstil apo me materiale të tjera.
6902	Tulla, bllloqe, pllaka, refraktare e mallra të ngjashëm ndërtimore qeramike refraktare, ndryshe nga ato prej miellrave të fosilit silicor apo prej dherave të ngjashëm silicore.
6904	Tullat ndërtuese qeramike, bllloqet e dysHEMEVE, pllaka mbështetëse apo mbushëse e të ngjashmet e tyre.
6905	Pllaka çatie, pllaka për oxhaqe, mbulesa të tubit të tymit, deflektor, ornamente arkitektuale e mallra të tjera qeramike ndërtimore.
6911	Pajisje tavoline, kuzhine, artikuj të tjerë shtëpiakë e artikuj të tualetit, prej porcelani apo prej fajance.
6912 00	Pajisje tavoline, kuzhine, artikuj të tjerë shtëpiakë e artikuj të tualetit, prej qeramike, ndryshe nga prej porcelani apo fajance.
7202	Ferro-lidhjet.
7208	Produkte të petëzuar me rul me profil të shpinës me dy kolona prej gize apo çeliku të palidhur, të një gjerësie prej 600 mm apo më shumë, e petëzuar në të nxehtë, jo i mbuluar, pllakëzuar apo veshur.
7211	Produkte të petëzuara me rul me profil të shpinës me dy kolona prej gize e çeliku jo të lidhur, të një gjerësie më pak se 600 mm, jo e mbuluar, pllakëzuar apo e veshur.
7213	Shufra e shkopinj, të petëzuara në të nxehtë, në spirale të përdredhura në mënyrë të çrregullt, prej

	gize e çeliku jo të lidhur.
7217	Tela prej gize dhe çeliku jo të lidhur.
7305	Tuba e tubacione ë tjera (psh të salduara, të percinuara apo të ngjitura në mënyrë të ngjashme), që kanë një seksion kryq rrethor, diametri i jashtëm i të cilave i kalon të 406.4 mm, prej gize apo çeliku.
7306	Tuba, tubacione e profije të tjera (p.sh. me tegele saldimi të hapura apo të salduara, percinuara apo të mbyllur në mënyra të ngjashme), prej gize dhe çeliku.
7307	Përshtatjet e tubave e të tubacioneve (psh mëngët, kthesat, bashkimet), prej gize e çeliku.
7308	Konstruksionet (përjashtojë parafabrikatet e kreut nr.94.06) e pjesët e konstruksioneve (p.sh. urat e seksionet e urave, porta shluze, kullat, shtylla për grilat, çatitë, skeletet e çative, dyert e dritaret e skeletet e tyre e pragjet për dyert, parmakë, shtylla e kolona) prej gize e çeliku; pllaka, shufra, kënde, forma, seksione, tuba e të ngjashmet e tyre, të përgatitur për përdorim në konstruksione, prej gize e çeliku.
7309 00	Rezervuarët, depozitat, kazanet e kontenerët e ngjashëm për çdo lloj materiali (përveçse për gazin e kompresuar apo të lëngëzuar), prej gize e çeliku, të një kapaciteti më tepër se sa 300 l, nëse janë apo jo të linjëzuara apo të izoluar në të nxehtë, por jo të përshtatura me pajisje mekanike apo termike.
7310	Depozitat, fuçitë, bidonat, kutitë e kontenerët e ngjashëm, për çdo lloj materiali (përveçse për gaz të kompresuar apo të lëngëzuar), prej gize e çeliku, e një kapaciteti jo më tepër se 300 l, nëse janë apo të linjëzuara apo të izoluar në të nxehtë, por jo të përshtatura me pajisje mekanike apo termike.
7313 00 00 00	Tela të dhëmbëzuar prej gize apo çeliku; unaza të përdredhura apo telat të vetëm të sheshtë, të dhëmbëzuar apo jo, e telat e dubluara lehtësisht të përdredhura, të një lloji të përdorur për gardhe prej gize apo çeliku.
7316 00 00 00	Spiranca për anije dhe spiranca për barka dhe pjesët e tyre, prej gize apo çeliku.
7320	Susta e fleta për susta, prej gize apo çeliku
7321	Stufat, soba për gatim, skare për qymyrin në vatër, sobat për gatim (përfshirë ato me ngrohës uji për ngrohje qendrore), hell, mangall, pipth gazi, pllakat ngrohëse e pajisje të ngjashme jo elektroshtëpiake, e pjesët prej tyre, prej gize apo çeliku.
7322	Radiatorët për ngrohje qendrore jo me ngrohje elektrike e pjesët prej tyre prej gize apo çeliku, ngrohësit e ajrit e shpërndarësit e ajrit të ngrohtë (përfshirë distributorët të cilët mund të shpërndajnë ajër të freskët dhe ajër të kondicionuar), jo me ngrohje elektrike, të trupëzuar me ventilatorin apo fryrëzin e pjesët prej tyre, prej gize apo çeliku.
7323	Pajisje tavoline, kuzhine e artikuj të tjerë shtëpiake e pjesët e tyre, prej gize apo çeliku; lesh gize apo çeliku; pastrues tenxheresh e mbushje për pastrim apo lustrim, dorezat e artikuj të ngjashëm të përdorur për këtë qëllim prej gize apo çeliku.
7325	Artikuj të tjerë të derdhur prej gize apo çeliku.
7413 00	Tela, kablo, banda të gërshetuara e të ngjashmet e tyre, të përdredhura prej bakri, jo të izoluar elektrikut.
7501	Metalinë nikeli, aglomerat i oksidit të nikelit e produkte të tjera ndërmjetëse në metalurgjinë e nikelit.
7504	Shufra, shkopinj e profije alumini.
7606	Pllaka, fleta e shirita alumini, të një trashësie më tepër se 0.2 mm
7608	Tuba e tubacione alumini
7610	Struktura alumini (përjashtojë ndërtesat parafabrikate të kreut Nr.9406) e pjesët e strukturave (psh urat e seksionet e urave, shtyllat, porta shluze, çati e struktura të çative, dyert e dritare e skeletet e tyre e pragjet për dyert, parmake, shtylla e kolona); pllaka, shufra, profije, tuba e të ngjashmet e tyre, prej alumini, përgatitur për përdorim në strukturat
7614	Tela, kablo, shirita të gërshetuara e artikuj të ngjashëm, të shumfishtë, prej alumini jo të izoluar elektrikut
8303 00	Kasaforta të armuara apo të përforcuara, kutitë kasaforta e dyer e mbyllës të dhomave në formë kasaforte, kutitë e parave cash apo për dokumentat me vlerë e të ngjashmet e tyre, prej metali bazë
8402	Bolierët që gjenerojnë avuj uji ose avuj të tjerë (të ndryshëm nga bolierët me ujë të nxehtë me nxehtë qendrore në gjendje gjithashtu të prodhojnë avuj me presion të vogël); bolierat me ujë super të nxehtë.
8403	Bolierët me nxehtë qendrore të ndryshme nga ato të kreut nr.8402.
8404	Impiantet ndihmës për t'u përdorur me bolierët e kreut nr.8402 apo 8403 (për shembull, ekonomizuesat, supernxehsat, tretësit e blazës, nxjerrësit e gazit): kondensuesit për njësitë e fuqisë me avuj uji apo për njësi të tjera fuqie avulli.
8413	Pompat për lëngjet, të përshtatura apo jo me një pajisje matëse; elevatorët e lëngut
8414	Pompat e ajrit apo vakum, kompresorët e ventilatorët e ajrit apo gazrave të tjera; thithësit e tymrave me ventilim apo ricklim bashkëngjitur një ventilatori, nëse janë apo jo të përshtatura me filtra
8418	Frigoriferët, ngritësit e pajisje të tjera ftohëse apo ngrirëse, elektrike apo të tjera; pompat e nxehtësisë të ndryshme nga kondicionerët e ajrit të kreut nr.8415
8419	Makineri, impiante apo pajisje laborator, nëse janë apo jo me nxehtë elektrike, për trajtimin e makinerive nga një proces që përfshin një ndryshim të temperaturës të tilla, si nxehtë, gatim,

	pjekje, distilim, pastrim, sterilizim, pasterizim, avullim, tharje, thithje avulli,. Kondensim apo ftohje, të ndryshme nga makineritë apo impiantet e një lloji të përdorur për qëllime shtëpiake; nxehtësat e menjëhershëm të ujit apo me ruajtje, jo elektrike.
8422	Makinat për larjen e pjatave; makineri për pastrimin apo tharjen e shisheve apo kontenierëve të tjerë; makineri për mbushjen, mbylljen, vulosjen apo etiketimin e shisheve, kanaçeve, kutive, çantave apo kontenierëve të tjerë; makineri për kapsulimin e shisheve, faqoreve, tubave e kontenierëve të ngjashëm; makineri të tjera paketimi apo mbështjelljeje (përfshirë makineritë e mbështjelljes me nxehtësi); makineri për gazimin e pijeve.
8423	Peshoret (përjashtoj peshoret e një ndjeshmërie prej 5 cg ose më të mirë), përfshirë peshoret e operuara për llogaritje apo kontrollim; peshat e të gjitha llojeve.
8424	Pajisjet mekanike (të operuara apo jo me dorë për hedhjen, shpërndarjen ose spërkatjen e lëngjeve apo pluhurave ; fikësit e zjarrit, të ngarkuara ose jo; armët sprucuese e pajisjet e ngjashme; makinat e pastrimit me avull ose me rrymë rëre e makinat e ngjashme të projektuara me hedhje.
8432	Makineri bujqësore, kopshtarie apo pylltarie për përgatitjen apo kultivimin e terrenit; rrulat për lëndina apo për tokë sportive.
8433	Makineri korrije apo shirje, përfshirë presat për ambalazhimin në dëngje të kashtës apo tagjisë; makinat kositëse të barit apo të barit të thatë; makinat për pastrimin, zgjedhjen apo klasifikimin e vezëve, frutave apo produkteve të tjera bujqësore, të ndryshme nga makineritë e kreut nr.8437.
8457	Qendrat e makinës, makinat me konstruksion njësi (me një stacion) e makinat me transferim shumë stacionesh për punimin e metalit.
8458	Tornot (përfshirë qendrat rrotulluese) për zhvendosjen e metalit.
8459	Veglat-makinë (përfshirë makinat kokënjësi të tipit vijë) për shpim, birim, vijëzim, fjetim apo bërje fjetosh nëpërmjet zhvendosjes së metalit, ndryshe nga tornot e kreut nr.84.58 (përfshirë qendrat rrotulluese).
8461	Veglat për punimin në motorët jo elektrike të dorës, pneumatikë, hidraulike apo të vetëkontrolluar.
8467	Boshtet e transmesionit (përfshirë boshtet me gunga e boshtet motorike) e manivelat; trup kuzhinete e kuzhinetat me bosht të rrafshët; ingranazhet me dhëmbë e mekanizmi i transmesionit me dhëmbë; vidat sferë apo vidat role; kutitë e shpejtësive e ndryshuesit e tjerë të shpejtësisë, përfshi hidrotransformatorët; volantët e pulexhat, përfshi kutitë e bllokut; xhuntut bashkuese të boshteve e ingranazheve (përfshi bashkimet universale).
8501	Motorët e gjeneratorët elektrikë (përjashtoj grup gjeneratorët).
8504	Transformatorët elektrikë, konvertuesat statikë (p.sh drejtuesat) e induktorët.
8504	Akumulatorët elektrike, përfshi ndarësat e tyre, nëse janë apo jo drejtkëndësh (përfshi katrotët).
8509	Pajisjet shtëpiake elektromekanike, me motorët elektrik të vetëkontrolluar
8515	Makina e aparate elektrike (përfshi ato me gaz të nxehtë elektrike), me rreze lazer, të tjera drite ose fotone, me ultratinguj, me rreze elektronesh, saldimi me plasmë të shkarkimit me hark ose impulse magnetike, për saldimin me saldaturë të ngrohtë ose për saldim, nëse janë të afta ose jo për prerje; makinat e aparatet elektrike për spërkatje në të ngrohtë të metaleve apo metaloqeramikave.
8516	Ngrohtësit e ujit të menjëhershëm ose me ruajtje e ngrohës me zhytje; aparatet e ngrohjes elektrike të hapësirës e aparatet e ngrohjes tokës; aparatet e kujdesjes së flokëve elektrotermike (p.sh tharësat e flokëve, dredhjes së flokëve, mashat) e tharësit e duarve; hekurat elektrikë të hekurosjes, pajisje të tjera elektrotermike të një lloji të përdorur për qëllime shtëpiake; rezistencat ngrohëse elektrike të ndryshme nga ato të kreut nr.8545.
8529	Pjesët e përshtatura për t'u përdorur vetëm ose kryesisht me aparatet e krerëve nr.8525 deri në 8528.
8534 00	Qarqet e stampuara
8535	Aparaturat elektrike për kyçjen ose mbrojtjen e qarqeve elektrike pse për të bërë lidhjen me ose në qarqet elektrike (p.sh. celësat, siguresat, rrufepritësit, kufizuesit e tensionit, zbutësit e mbitensionit, prizat, spinat, portollampa, kutitë e bashkimit), për një tension që e kalon 1 000 Voltet.
8536	Aparaturat elektrike për kyçjen ose mbrojtjen e qarqeve elektrike, ose për bërjen e lidhjeve me ose në qarqet elektrike (psh celësat, reletë, siguresat, kufizuesit e tensionit, zbutësit e mbitensionit, prizat, spinat, portollampat, kutitë e bashkimit), për një tension që nuk e kalon 1 000 Voltet.
8537	Bordet, panelet, konsolat, tavolinat, kabinetet e baza të tjera, të pajisura me dy ose me shumë aparature të kreut nr.8535 ose 8536, për kontroll elektrik ose shpërndarjen e elektricitetit, përfshi ato bashkëngjitur instrumentave apo aparateve të kapitullit 90, e aparatet e kontrollit numerik, ndryshe nga aparatet e hapjes apo mbylljes të kreut nr.8517.
8538	Pjesët e përshtatshme për t'u përdorur vetëm ose kryesisht me aparatet e kreut nr.8535, 8536, ose 8537.
8539	Llampat elektrike me filament ose me shkarkim, përfshi njësitë me llampa me rreze të padukshme e llambat ultra vjollcë ose infra të kuqe; llambat me hark .
8544	Telat e izoluar (përfshi të zmaltuara ose të anodizuara) kabllot e izoluar (përfshi kabllot koaksiale) e përcjellësa të tjerë elektrikë të izoluar, të përshtatur ose jo me lidhësa; kabllot me fibra optikë, të bërë nga fibra individuale me lëvizshmëri, nëse janë të montuara ose jo me përcjellësa elektrike ose të

8607	përshtatur me lidhësa. Pjesët e lokomotivës të hekurudhave ose tramvajve apo të vagonave të hekurudhave apo tramvajeve.
8702	Mjetet e transportit me motorr për transportin e dhjetë ose me shumë personave përfshirë shoferin.
8706 00	Shasitë e përshtuatura me motorra, për mjetet e transportit të krerëve nr.8701 deri 8705.
8707	Trupat (përfshi kabinat),për mjetet e transportit të krerëve nr.8701 deri 8705.
8708	Pjesët e plotësuesit e mjeteve të transportit të krerëve Nr.8701 deri 8705
8716	Rimorkiot e gjysërrimorkiot; mjete të tjera transporti të lëvizur jo mekanikisht, pjesët e tyre.
9028	Matësit e ushqimit ose prodhimit të gazit, lëngut ose elektricitetit, përfshi kalibrim martelat e tyre.
9107 00 00 00	Çelësat kohorë me lëvizës ore apo memotor sinkronizues.
9401	Ndenjëset (të ndryshme nga ato të kreut nr.9402), nëse janë ose jo të kthyeshme në krevate, e pjesët e tyre.
9403	Mobileri të tjera e pjesët e tyre.
9406 00	Ndërtesa të parafabrikuara.

ANEKSI IV

(I referohet paragrafit 1 të nenit 29)

Mbrojtja e të drejtave të pronësisë intelektuale

Marrëveshjet shumëpalëshe të përmendura në paragrafin 1 të nenit 29 janë si më poshtë :

1	Konventa e Parisit e datës 20 mars 1883 për Mbrojtjen e Pronësisë Intelektuale (Akti i Stokholmit i vitit 1967, i ndryshuar me 1979);
2	Konventa e Bernës e datës 9 shtator 1886 për Mbrojtjen e Veprave Letrare dhe Artistike (Akti i Parisit i vitit 1971);
3	Konventa Ndërkombëtare e datës 26 tetor 1961 për Mbrojtjen e Prodhuesve dhe Ekzekutuesve të Fonogramëve dhe të Organizatave Transmetuese (Konventa e Romës);
4	Marrëveshja e Madridit lidhur me Regjistrimin e Markave Ndërkombëtare (Akti i Stokholmit i vitit 1967, i ndryshuar me 1979);
5	Traktati i Bashkëpunimit për Patentat (Washington më 1970, i ndryshuar më 1979 dhe me 1984);
6	Konventa që krijoi Organizatën Botërore të Pronësisë Intelektuale (Akti i Stokholmit i vitit 1967, i ndryshuar me 1979);

NDREQJE GABIMI

Në Fletoren Zyrtare Nr. 5, ligji nr. 8858 datë 14.2.2002, neni 1 pika 4 është:

4. Paragrafët me numër 14 dhe 5 të nenit 10 shfuqizohen.

duhet:

4. Paragrafët me numër 14 dhe 15 të nenit 10 shfuqizohen.

Fletorja Zyrtare gjendet:

- Në çdo njësi postare të çdo qyteti;
 - Pranë Qendrës së Publikimeve Zyrtare:
- Rr.Qemal Stafa, pranë ndërtesës së Prokurorisë së Përgjithshme.

U dorëzua për shtyp më 12. 6. 2002
Doli nga shtypi më 13. 6. 2002

Tirazhi: 4250 copë	Formati: 60x88/8
--------------------	------------------

Shtypshkronja e Qendrës së Publikimeve Zyrtare
Tiranë, 2002

Çmimi: 350 lekë